The background of the page is a photograph of ancient stone ruins in Kosovo. It features a large, weathered stone column on the left, a wall of rough-hewn stones in the center, and a large, rectangular stone block in the foreground. The scene is brightly lit, suggesting a sunny day.

# Sfidat në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të paluajtshme materiale në Kosovë

Mars, 2014



## **MARS, 2014**

### **Mohim përgjegjësie:**

Versioni i këtij publikimi në gjuhën angleze është versioni zyrtar. Gjitha versionet e këtij publikimi në gjuhët tjera janë përkthim nga versioni origjinal në anglisht, si dhe nuk janë dokumente zyrtare.

# PËRMBAJTJA

|   |    |
|---|----|
| LISTA E SHKURTESAVE   | 3  |
| PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE  | 5  |
| 1. HYRJE  | 7  |
| 2. KORNIZAT LIGJORE DHE INSTITUCIONALE PËR MBROJTJEN E TRASHËGIMISË KULTURORE NË KOSOVË | 8  |
| 2.1 Korniza ndërkombëtare e të drejtave të njeriut                                      | 8  |
| 2.2 Korniza ligjore e Kosovës   | 9  |
| 2.3 Korniza institucionale e Kosovës  | 11 |
| 3. BRENGAT E PËRGJITHSHME NË MBROJTJEN E TRASHËGIMISË KULTURORE                         | 14 |
| 3.1 Inventarizimi i pasurive të trashëgimisë kulturore                                  | 14 |
| 3.2 Planifikimi Hapësinor   | 15 |
| 3.3 Inspektimi i vendeve të trashëgimisë kulturore                                      | 17 |
| 4. SHQETËSIME SHITESË LIDHUR ME MBROJTJEN E TRASHËGIMISË SË KOMUNITETEVE JOSHQIPTARE    | 21 |
| 4.1 Masat e sigurisë dhe mbrojtjes  | 21 |
| 4.2 Cenimi i të drejtave pronësore të Kishës Ortodokse Serbe                            | 24 |
| 4.3 Promovimi i trashëgimisë kulturore  | 26 |
| 5. KONKLUZË   | 28 |
| 6. REKOMANDIME  | 29 |



---

# LISTA E SHKURTESAVE

---

**KDESK**

Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore

---

**PNDKP**

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike

---

**PNDESK**

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore

---

**KZM**

Këshilli Zbatues dhe Monitorues

---

**KKTK**

Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore

---

**KFOR**

Forcat e NATO-s në Kosovë

---

**IMMK**

Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve të Kosovës

---

**MKRS**

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

---

**PZHK**

Plani Zhvillimor Komunal

---

**MMPH**

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

---

**MAPL**

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

---

**OSBE**

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë Misioni në Kosovë

---

**KRZ**

Këshilli për Rindërtim dhe Zbatim

---

**QRTK**

Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore

---

**ZVM**

Zonat e Veçanta të Mbrojtura

---

**DUDNJ**

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut

---

**PZHU**

Plani Zhvillimor Urban

---

**UNESCO**

Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë

---

**UNMIK**

Administrata e Përkohshme e OKB-së në Kosovë

---



---

# PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

---

Në Kosovë ekziston një trashëgimi e pasur dhe e larmishme kulturore dhe fetare e cila po rrezikohet nga mungesa e ruajtjes, mbrojtjes dhe promovimit. Lënia pas dore dhe vandalizmi i monumenteve, rritja e pakontrolluar urbane dhe studime të pamjaftueshme që kanë për qëllim gjetjen e një balance mes mbrojtjes së trashëgimisë kulturore dhe fetare dhe të drejtave të individëve dhe komuniteteve që jetojnë afër monumenteve, po e rrezikojnë këtë trashëgimi. Ky raport vlerëson nëse korniza ligjore e Kosovës është në përputhje me standardet përkatëse ndërkombëtare për të drejtat e njeriut që kanë të bëjnë me mbrojtjen e trashëgimisë së paluajtshme kulturore dhe në çfarë shkalle i aplikojnë institucionet qendrore dhe lokale këto standarde duke i respektuar, mbrojtur dhe plotësuar të drejtat e të gjithë personave për qasje dhe përfitim nga trashëgimia kulturore.

Korniza ligjore e Kosovës që ka të bëjë me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore është përgjithësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Megjithatë, korniza ligjore nuk përcakton në mënyrë të qartë ndarjen e përgjegjësisë në mes të institucioneve të ndryshme. Si rrjedhojë, Misioni i OSBE-së në Kosovë (OSBE), përmes aktiviteteve të tij të monitorimit, ka vërejtur që vazhdon të ketë mangësi në zbatimin e kornizës ligjore për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe institucionet përgjegjëse vazhdojnë të jenë në masë të madhe joefektive.

Mangësitë e identifikuara përfshijnë, ndër të tjera, dështimin për të zhvilluar një inventar të plotë për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe dështimi për t'i integruar vendet e trashëgimisë kulturore në planet lokale hapësinore. Përveç kësaj, në kundërshtim me kornizën ligjore, ka pasur mungesë të inspektimit të vendeve të trashëgimisë kulturore, duke rezultuar në dështimin për t'i parandaluar ndërtimet e paligjshme që prekin vendet e trashëgimisë, veçanërisht ato të Kishës Ortodokse Serbe. Shkatërrimet, aktet e vandalizmit, vjedhjet, vendimet negative komunale dhe aktivitetet tjera destruktive vazhdojnë të

kenë ndikim në vendet e trashëgimisë kulturore, veçanërisht ato të Kishës Ortodokse Serbe.

Më tej, OSBE-ja ka vërejtur se, përkundër natyrës ndërsektoriale të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, bashkëpunimi në mes të institucioneve vendore dhe të nivelit qendror, si dhe ndërmjet ministrive të ndryshme të linjës ka qenë minimal, si dhe i ka vërejtur vetëm disa iniciativa të përbashkëta mes institucioneve që kanë për synim promovimin e ruajtjes së trashëgimisë materiale kulturore, veçanërisht të komuniteteve joshqiptare. Kapacitetet e kufizuara të stafit dhe mungesa e zotimit politik kanë penguar zbatimin e mëtejshëm të kornizës ligjore për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Për këto arsye, efektiviteti i institucioneve qendrore dhe lokale në zbatimin e standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore është i kufizuar. Kjo nuk do të thotë se nuk ka pasur zhvillime pozitive. Edhe Këshilli Zbatues dhe Monitorues (KZM) edhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (MKRS) kanë trajtuar disa raste të ndërtimeve të paligjshme që prekin ZVM-të dhe vendet tjera të trashëgimisë kulturore, të cilat kanë nxjerrë disa rezultate pozitive.

Ligji për trashëgiminë kulturore aktualisht është në fazë të ndryshimit dhe plotësimit, duke mundësuar përkufizim më të mirë të përgjegjësisë përkatëse të institucioneve të Kosovës të angazhuara në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, duke përfshirë divizionin për menaxhimin e integruar të trashëgimisë kulturore në MKRS më 2012. Megjithatë, mbetet të shihet çfarë ndryshime do të sjellë ligji i ndryshuar dhe si do të ndihmojnë ato ndryshime në trajtimin e mangësive të identifikuara në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe fetare në Kosovë.

OSBE-ja i bën thirrje institucioneve të Kosovës që të sigurojnë zbatim të plotë të kornizës ligjore për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, si dhe të sigurojë se të gjitha institucionet përkatëse janë të pajisura me staf të mjaftueshëm dhe se janë tërësisht funksionale. Për këtë qëllim, institucionet e Kosovës

duhet t'i përcaktojnë qartë rolet e institucioneve qendrore dhe lokale në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, si dhe të përmirësojnë koordinimin ndërmjet të gjithë aktorëve. Për më tepër, OSBE-ja inkurajon institucionet përkatëse që të sigurojnë

dënim të menjëhershëm të të gjitha incidenteve të sigurisë që prekin vendet e trashëgimisë kulturore, në veçanti të komuniteteve joshqiptare, si dhe aktivitete adekuate të komunikimit me qëllim që të ofrojnë qetësi për komunitetet e prekura.



---

# 1. HYRJE

---

Si pjesë e mandatit të saj për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve në Kosovë, OSBE-ja monitoron dhe mbështet mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të të gjitha komuniteteve në Kosovë, nga trashëgimia arkitekturore dhe arkeologjike deri te traditat zakonore si artet dhe zanatet. Mbrojtja e trashëgimisë kulturore e të gjitha komuniteteve është në interesin publik të të gjithë personave të Kosovës. Ta ruash trashëgiminë kulturore do të thotë t'i mbash dhe avancosh vlerat e saj dhe ta bësh atë të qasshme; pastaj, ajo ruajtje ndihmon në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore meqë bëhet pjesë e gjallë e komunitetit. Komunitetet pastaj mund të përfitojnë në aspekt ekonomik dhe kulturor nga përdorimi dhe promovimi i trashëgimisë kulturore, që edhe e nënvizon vlerën dhe nevojën për mbrojtjen e saj. Për më tepër, mbrojtja dhe rehabilitimi i trashëgimisë kulturore në Kosovë mund të luaj rol themelor në nxitjen e pajtimit dhe dialogut ndëretnik.

Lënia pas dore dhe vandalizmi i vendeve dhe zvarritjet në integrimin e trashëgimisë kulturore dhe fetare në planifikimin hapësinor rrezikojnë mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të paluajtshme materiale. Duke pasur parasysh zhvillimin e shpejtë urban në Kosovë, është me rëndësi të sigurohet setë gjitha planet e propozuara hapësinore marrin parasysh nevojën për mbrojtjen e vendeve të trashëgimisë kulturore. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për vendet kulturore të komuniteteve joshqiptare dhe atyre që nuk mund të marrin pjesë në procesin e konsultimeve publike për shkak të zhvendosjes.

Në përgjigje ndaj incidenteve të veçanta kundër trashëgimisë kulturore, OSBE-ja dhe organizatat e tjera ndërkombëtare, si dhe institucionet e Kosovës, kanë shprehur shqetësimet e tyre për sa i përket mbrojtjes dhe ruajtjes së trashëgimisë kulturore.

Për t'i identifikuar më mirë mangësitë dhe sfidat që prekin mbrojtjen e vendeve ekzistuese të trashëgimisë kulturore në Kosovë dhe rrjedhimisht të promovojë ruajtjen e tyre, OSBE-ja ka përdorur një qasje të bazuar në të drejtat e njeriut të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore për të vlerësuar përputhshmërinë e kornizës ligjore të Kosovës për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore me standardet

përkatëse ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, dhe niveli në të cilin përgjegjësit në fushën e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore të paluajtshme materiale veprojnë në përputhje me këtë kornizë.

Raporti bazohet në aktivitetet e rregullta të monitorimit të OSBE-së në fushën e mbrojtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore të kryera në periudhën nga janari 2010 deri në shkurt 2014, si dhe në 44 intervista të kryera me zyrtarë përgjegjës dhe komunitete të prekura në periudhën shtator 2011 dhe tetor 2013. Çështjet e identifikuar në intervista janë monitoruar më tutje gjatë vitit 2012 dhe 2013. Përveç kësaj, raporti merr parasysh çështjet e ngritura nga akterë të ndryshëm në pesë punëtori në nivelin lokal me temën "Legjislacioni për trashëgiminë kulturore: zbatimi dhe sfidat" të organizuara në gjysmën e dytë të qershorit të vitit 2012 si pjesë e projektit të OSBE-së për mbështetjen e institucioneve të nivelit lokal në promovimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe fetare në Kosovë.

Pas shënimeve hyrëse, kapitulli i dytë paraqet standardet përkatëse ndërkombëtare të të drejtave të njeriut që rregullojnë mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Gjithashtu, në këtë kapitull përshkruhet dhe vlerësohet përshtatshmëria e ligjeve dhe politikave vendore për mishërimin e këtyre standardeve ndërkombëtare. Përveç kësaj, ajo përshkruan kornizën institucionale përgjegjëse për të siguruar zbatim të ligjeve vendore. Në kapitullin e tretë është bërë një vlerësim i performancës së bartëseve përkatës të përgjegjësive në përmbushjen e obligimeve të tyre që kanë të bëjnë me trashëgiminë kulturore në fushat kyçe të identifikuar si inventarizimi i aseteve, planifikimi hapësinor dhe inspektimi i vendeve të trashëgimisë kulturore. Kapitulli i katërt vlerëson shqetësimet specifike që kanë të bëjnë me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore materiale të komuniteteve joshqiptare, në veçanti incidentet e sigurisë në vendet e trashëgimisë, shkeljet e të drejtave pronësore dhe promovimi i trashëgimisë kulturore. Në kapitullin e pestë janë përvijuar konkluzat kryesore të vlerësimit dhe në fund, në kapitullin e gjashtë, janë paraqitur rekomandimet për organet përgjegjëse për mbushjen e hendeqeve në kornizën ligjore dhe zbatimin e saj.

---

# 2. KORNIZAT LIGJORE DHE INSTITUCIONALE PËR MBROJTJEN E TRASHËGIMISË KULTURORE NË KOSOVË

---

## 2.1 Korniza ndërkombëtare e të drejtave të njeriut

Përderisa nuk ka përkufizim universal të trashëgimisë kulturore, ajo përgjithësisht i referohet objekteve, vendeve dhe traditave që përkufizojnë individë, komunitete, shoqëri, kombe dhe civilizime. Ajo mund të jetë e materiale (p.sh. monumente, artefakte, antikitet, arte, ndërtesa historike, lokacione arkeologjike dhe vende të shenjta)<sup>1</sup>, jomateriale (p.sh. “praktikat, përfaqësimet, shprehjet, njohuritë, shkathtësitë – si dhe instrumentet, objektet, artefaktet dhe hapësirat kulturore të lidhura me to – të cilat komunitetet, grupet dhe në disa raste edhe individët i identifikojnë si pjesë të trashëgimisë së tyre kulturore”<sup>2</sup>) apo natyrore<sup>3</sup> (p.sh. rezervatet e mbrojtura natyrore, parqet apo kopshtet historike dhe peizazhet kulturore, të cilat janë vende karakteri të cilave sipas perceptimit të njerëzve është rezultat i veprimit dhe bashkëveprimit të faktorëve natyrorë dhe/apo njerëzorë<sup>4</sup>). Koncepti i trashëgimisë pasqyron karakterin dinamik të një gjëje që është krijuar, interpretuar dhe riinterpretuar përgjatë kohës dhe bartur nga gjenerata në gjeneratë. Nga perspektiva e të drejtave të njeriut, trashëgimia kulturore gjithashtu duhet të kuptohet si resurse që mundësojnë identifikimin kulturor dhe procese të zhvillimit të individëve dhe komuniteteve<sup>5</sup>.

E drejta në trashëgimi kulturore është e drejtë e njohur ndërkombëtarisht në disa instrumente të ndryshme për të drejtat e njeriut dhe në praktikën e organeve për monitorimin e të drejtave të njeriut,

duke përfshirë të drejtën për të marrë pjesë në jetën kulturore<sup>6</sup> dhe të drejtën e pjesëtarëve të grupeve të pakicave ta gëzojnë kulturën e tyre<sup>7</sup>. E drejta e të gjithëve për të marrë pjesë në jetën kulturore, siç përcaktohet me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut dhe Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (PNDESK), obligon institucionet që të respektojnë, mbrojnë dhe përmbushin gëzimin e së drejtës.<sup>8</sup> Obligimet për respektimin dhe mbrojtjen e mundësisë për të marrë pjesë në jetën kulturore kërkojnë që institucionet të përmbahen nga ndërhyrja dhe të marrin hapa për t'i ndaluar palët e treta nga ndërhyrja, e drejtpërdrejtë apo e tërthortë, në ushtrimin e së drejtës; ndërsa obligimi për përmbushje obligon institucionet që t'i ndërmarrin masat e duhura legislative, administrative, gjyqësore, promocionale dhe të tjera që kanë për qëllim realizimin e plotë të së drejtës.<sup>9</sup>

Të drejta të shumta ndërkombëtare të njeriut dhe liri themelore garantojnë drejtpërsëdrejti sipas ligjeve të Kosovës, duke përfshirë edhe ato të përfshira në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (PNDKP) dhe protokollet e tij, Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe protokollet e saj, Konventën Kornizë të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, si dhe PNDESK<sup>10</sup>.

---

Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në veçanti i referohet obligimit të institucioneve për t'i "promovuar kushtet e nevojshme për personat që i përkasin pakicave kombëtare për ta mbajtur dhe zhvilluar kulturën e tyre dhe për t'i ruajtur elementet thelbësore të identitetit të tyre, gjegjësisht fenë, gjuhën, traditat dhe trashëgiminë kulturore të tyre".<sup>11</sup> Normat tjera të të drejtave të njeriut që po ashtu duhet të merren parasysh dhe interpretohen në lidhje me të drejtën në trashëgimi kulturore përfshijnë, mes tjerash: parimin e mosdiskriminimit, në veçanti, në baza të identitetit kulturor; e drejta në shkollim; e drejta në liri të shprehjes; e drejta në informata; dhe e drejta në liri të mendimit dhe fesë<sup>12</sup>.

Viteve të fundit, në mekanizmat ndërkombëtarë dhe rajonalë për të drejtat e njeriut është fuqizuar lidhja ndërmjet trashëgimisë kulturore, diversitetit kulturor dhe të drejtave kulturore.<sup>13</sup> Për t'i respektuar dhe mbrojtur të drejtat për të marrë pjesë në jetën kulturore dhe për ta gëzuar kulturën personale, institucionet duhet ta ruajnë trashëgiminë kulturore materiale me qëllim që ta mbajnë autenticitetin dhe integritetin e saj, të mbrojnë trashëgiminë kulturore jomateriale për të siguruar qëndrueshmëri dhe vazhdimësi, si dhe të garantojnë të drejtat e të gjithë individëve dhe komuniteteve që të kenë qasje dhe përfitim nga trashëgimia e tyre kulturore. Pjesëmarrja efektive e individëve dhe komuniteteve në procesin e vendimmarrjes që ka të bëjë me trashëgiminë kulturore është po ashtu e nevojshme për të siguruar realizim të plotë të të drejtave të tyre kulturore<sup>14</sup>.

Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Vlerën Trashëgimisë Kulturore për Shoqërinë i referohet të drejtave të trashëgimisë kulturore dhe përcakton që "që çdo person ka të drejtë të angazhohet me

trashëgiminë kulturore të përzgjedhur si aspekt i së drejtës për pjesëmarrje të lirë në jetën kulturore"<sup>15</sup>. Duke theksuar "nevojën për t'i përfshirë të gjithë në shoqëri në procesin e vazhdueshëm të përkufizimit dhe menaxhimit të trashëgimisë kulturore", ajo përmban referenca në të drejtën për të përfituar nga trashëgimia kulturore dhe për të kontribuar drejt pasurimit, pjesëmarrjes së të gjithëve "në procesin e identifikimit, studimit, interpretimit, mbrojtjes, konservimit dhe prezantimit të trashëgimisë kulturore", dhe të drejtave për "qasje në trashëgimi kulturore dhe pjesëmarrje demokratike".<sup>16</sup> E drejta e qasjes në trashëgimi kulturore i referohet sigurimit të 1) qasjes fizike në trashëgimi kulturore, që mund të përfshijë edhe qasjen në teknologji të informacionit;<sup>17</sup> 2) qasje ekonomike, që do të thotë qasje të përballeshme për të gjithë; 3) qasje në informata, që i referohet të drejtës për të kërkuar, pranuar dhe bartur informata për trashëgiminë kulturore; dhe 4) qasja në proceset e vendimmarrjes dhe monitorimit, duke përfshirë procedurat administrative dhe mjetet juridike gjyqësore. Ky koncept bazohet në parimin korrespondues të mosdiskriminimit, me vëmendje të posaçme kushtuar grupeve të cënueshme.<sup>18</sup>

Gëzimi i të gjitha të drejtave të njeriut kërkon qasje në mjete juridike efektive, duke përfshirë mjetet administrative dhe gjyqësore. Mjetet i duhen vënë në dispozicion individëve dhe komuniteteve, trashëgimia kulturore e të cilave nuk respektohet apo/dhe nuk mbrohet plotësisht, ose e drejta e të cilëve për qasje dhe gëzim të trashëgimisë kulturore është cenuar. Marrëdhënia specifike mes komuniteteve dhe trashëgimisë së tyre kulturore duhet marrë parasysh në proceset e arbitrazhit dhe ato gjyqësore<sup>19</sup>. Një mjet efektiv juridik, në rast të cenimit të një të drejte të njeriut, duhet të sigurojë "kthimin në gjendjen e mëparshme" deri në masën e mundshme dhe/ose kompensimin e dëmeve.<sup>20</sup>

## 2.2 Korniza ligjore e Kosovës

Korniza ligjore e Kosovës parasheh ruajtjen, mbrojtjen, qasjen publike, komunikimin dhe ofrimin e resurseve të domosdoshme për të lehtësuar gëzimin e trashëgimisë kulturore nga gjeneratat aktuale dhe të ardhme, si dhe parasheh veçanërisht promovimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të komuniteteve të Kosovës.

Institucionet e Kosovës kanë përgjegjësi për të ruajtur dhe mbrojtur trashëgiminë kulturore dhe fetare të të gjitha komuniteteve, si dhe do të sigurojnë mbrojtjen efektive të të gjitha objekteve dhe monumenteve me rëndësi kulturore e fetare për komunitete në tërësi.





*Hamami i Mehmet Pashës, Prizren*

Për t'i dhënë më shumë kuptim këtyre obligimeve, Ligji për Zonat e Mbrojtjes së Veçantë<sup>21</sup>, Ligji për Trashëgimi Kulturor<sup>22</sup> si dhe shtatë aktet përkatëse nënligjore<sup>23</sup> nxjerrë nga MKRS-ja përcaktojnë modalitetet e veçanta për implementimin e këtyre masave mbrojtëse. Ligji për Qendrën Historike të Prizrenit<sup>24</sup> si dhe Ligji për Fshatin e Hoçës së Madhe<sup>25</sup>, të cilat parashikojnë veçanërisht se çfarë përfshin mbrojtja e këtyre dy zonave<sup>26</sup>, janë shpallur më 2012; dy udhëzimet përkatëse administrative kanë qenë në hartim e sipër në kohën e shkrimit.<sup>27</sup> Më tutje, Plani Vjetor i Punës i Qeverisë për 2012 ka paraparë hartimin e një strategjie për trashëgiminë kulturore<sup>28</sup>. Në tetor të vitit 2013, është themeluar një grup punues, i cili që atëherë ka përfunduar versionin e parë të një plani veprimi për parandalimin e trafikimit të paligjshëm dhe gërmimit të paligjshëm të trashëgimisë kulturore të luajtshme. Megjithatë, nuk është hartuar ndonjë strategji për mbrojtjen efektive të trashëgimisë së paluajtshme kulturore

dhe fetare të të gjitha komuniteteve.<sup>29</sup>

Derisa Ligji për Trashëgiminë Kulturorë është përgjithësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare, ligji nuk qartëson se cila agjenci është përgjegjëse për cilën detyrë (termi “institucioni kompetent” përmendet në tërë dokumentin, pa emëruar agjencinë specifike). Ky është problem i veçantë në fushën e inspektimeve, sepse është e paqartë nëse inspektimi është përgjegjësi e institucioneve qendrore apo lokale. Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për Trashëgiminë Kulturorë janë hartuar gjatë viteve 2012 dhe 2013<sup>30</sup>, me qëllim të trajtimit të disa mangësive në ligjin ekzistues, të cilat pengojnë mbrojtjen dhe promovimin efektiv të objekteve të trashëgimisë kulturore. Edhe pse projektligji i ri për trashëgiminë kulturore është ende në hartim e sipër në MKRS, diskutimet në lidhje me projektligjin aktualisht janë fokusuar në caktimin e përgjegjësive të institucioneve, sigurimin



---

e përfaqësimit të komuniteteve në organet vendim-marrëse të trashëgimisë kulturore, qartësimin e sanksioneve ndaj shkeljeve të dispozitave ligjore, si dhe harmonizimin e terminologjisë relevante.<sup>31</sup>

Ligje të tjera me rëndësi për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe fetare janë edhe Ligji

për Vetëqeverisje Lokale<sup>32</sup>, Ligji për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Kosovë<sup>33</sup>, Ligji për Planifikim Hapësinor<sup>34</sup> si dhe Ligji për Ndërtimin<sup>35</sup>.

## 2.3 Korniza institucionale e Kosovës

Departamenti për Trashëgimi Kulturor në MKRS është përgjegjës për menaxhimin e trashëgimisë kulturore në Kosovë. Ai menaxhon Institutin e Kosovës për Mbrojtje të Monumenteve (IKMM) dhe gjashtë qendrat rajonale për trashëgimi kulturor (QRTK) në Prishtinë, Prizren, Pejë, Gjakovë, Mitrovicë dhe Gjilan, të cilat mbajnë përgjegjësi për mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore materiale. Ato kanë përgjegjësi të përgjithshme për mbrojtjen dhe restaurimin e objekteve historike dhe për ndërtimet e lejuara brenda zonave historike, edhe pse kjo përgjegjësi nuk është ushtruar në mënyrën e duhur në të kaluarën – duke shkaktuar kështu dëmtimin e objekteve historike përtej riparimit, si dhe shumë ndërtime të paautorizuara që janë ngritur brenda zonave historike të Kosovës. Instituti Arkeologjik dhe Muzeu i Kosovës gjithashtu menaxhohen nga Departamenti i MKRS-së për Trashëgimi Kulturor. Këto institucione merren me trashëgiminë arkeologjike dhe janë përgjegjëse për restaurimin, konservimin, mbrojtjen dhe prezantimin e vlerave të trashëgimisë kulturore. Përveç këtyre, në secilën komunë, drejtori i kulturës (përfshirë trashëgiminë kulturore), raporton tek institutet rajonale për mbrojtje të monumenteve, por edhe tek niveli qendror në MKRS.

Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturor (KKTK)<sup>36</sup>, organ ky këshillues i Kuvendit të Kosovës, ka për detyrë të miratojë Listën e Trashëgimisë Kulturore<sup>37</sup>, të identifikojë masat prioritare për përkrahje financiare për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore<sup>38</sup> si dhe të shqyrtojë projekt-propozimet në lidhje me trashëgiminë kulturore.<sup>39</sup> Tutje, KKTK-ja ka të pranuar edhe përgjegjësinë për përkrahjen e ruajtjes, konservimit dhe menaxhimit të trashëgimisë kulturore.<sup>40</sup> Megjithatë, KKTK-ja nuk ka qenë funksional që prej themelimit të tij. Derisa është themeluar bordi ekzekutiv, anëtarësia asnjëherë nuk ka qenë e plotë. Përveç këtyre, parashihet që

anëtarët e KKTK-së të përfaqësojnë komunitete të ndryshme, gjë që deri tani nuk ka ndodhur.<sup>41</sup>

Departament për Planifikim Hapësinor dhe Instituti i Planifikimit Hapësinor në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) janë të angazhuar në mbrojtjen e Zonave të Mbrojtjes së Veçantë (ZMV) si dhe të siguroarit që planet hapësinore për hapësirat brenda ZMV-ve të jenë në përputhje me ligjet që rregullojnë ato ZMV.

Më 2 korrik 2013, Këshilli i Prizrenit për Trashëgimi Kulturor është themeluar në pajtim me Ligjin për Qendrën Historike të Prizrenit<sup>42</sup>, në përbërje të shtatëve anëtarëve që përfaqësojnë liderët e tri bashkësive kryesore fetare, gjegjësisht Kishës Ortodokse, Bashkësisë Islame dhe komuniteti katolik, si dhe përfaqësues të shoqërisë civile dhe një anëtar i pushtetit lokal. Këshilli ofron një forum për aktorët relevantë për të ndarë informata në lidhje me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe fetare në qendrën historike të Prizrenit.<sup>43</sup> Ndryshe, Këshilli për Trashëgimi Kulturor të fshatit Hoçë e Madhe ende nuk është themeluar.<sup>44</sup>

Përveç MKRS-së dhe MMPH-së, edhe Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe Ministria për Komunitete e Kthim, kanë një lloj rëndësie në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Edhe pse korniza ligjore nuk përcakton qartë rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve të lartpërmendura, ato në fakt angazhohen në aktivitete që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore. Për shembull, në qershor të vitit 2008, ato kanë marrë pjesë në një grup ndërmintor pune për komunikim dhe implementim të Ligjit për Zonat e Veçanta të Mbrojtjes, i cili është themeluar dhe bashkëkryesuar nga MMPH dhe MKRS. Grupi i punës gjithashtu ka pasur për detyrë të përfundojë dhe publikojë hartat



### *Qendra Historike e Prizrenit*

e ZMV-ve; të mbikëqyrë integrimin e ZMV-ve në planet hapësinore të nivelit lokal dhe atij qendror; të definojë procedurat administrative për menaxhimin e ZMV-ve; si dhe të ndërmarrë aktivitete informimi dhe vetëdijesimi për ZMV-të. Megjithatë, ky grup punues nuk ka qenë funksional për disa vite me radhë<sup>45</sup>.

KIM është organ i veçantë i cili së pari është bërë funksional në qershor të vitit 2010 për të monitoruar dhe lehtësuar zbatimin e Ligjit për Zonat e Veçanta të Mbrojtjes<sup>46</sup>. Lehtësuesi për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe fetare të Kishës Ortodokse Serbe ishte emëruar si kryesues i KIM-së; megjithatë, në formën e vet origjinale, në lidhje me mbledhjet e mirëfillta, KIM ka komunikuar përmes një korrespondence letrash mes anëtarëve të tij<sup>47</sup>. Efikasiteti i KIM-së ishte dëmtuar për këtë shkak, por edhe për shkak të mungesës së pjesëmarrjes, mungesës së qartësisë në lidhje me autoritetin e tij vendimmarrës, dështimit në përfshirje të MMPH-së në mekanizëm, si dhe animeve të perceptuara politike.

Më 12 shkurt 2013, Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor nënshkroi Udhëzimin Administrativ për themelimin e KIM-së.<sup>48</sup> Udhëzimi Administrativ përkufizon rolin e KIM-së, duke paraparë që ai “monitoron dhe lehtëson implementimin e dispozitave të legjislacionit në lidhje me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe fetare të Kishës Ortodokse Serbe duke përfshirë në veçanti dispozitat e Ligjit për Zonat e Veçanta të Mbrojtjes, Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit, si dhe Ligjit për Fshatin Hoçë e Madhe”<sup>49</sup>. Në bazë të Udhëzimit të ri Administrativ, KIM ka pesë anëtarë: nga një përfaqësues nga MMPH, MKRS, Bashkimi Evropian, OSBE dhe Kisha Ortodokse Serbe<sup>50</sup>. KIM aktualisht takohet në baza mujore për të diskutuar çështjet më të ngutshme të trashëgimisë kulturore, si dhe tashmë ka arritur disa rezultate pozitive<sup>51</sup>.

Para ri-themelimit të KIM-së, Komisioni për Rindërtim dhe Implementim i udhëhequr nga Këshilli i Evropës (KRI) ishte i vetmi mekanizëm ku Kisha Ortodokse Serbe dhe institucionet e Kosovës formalisht diskutonin çështjet e trashëgimisë

---

kulturore. KRI fillimisht ishte themeluar për të menaxhuar restaurimin dhe rindërtimin e 31 objekteve të Kishës Ortodokse Serbe, të cilat ishin dëmtuar gjatë trazirave të marsit 2004; megjithatë, mandati i tij përfundoi më 2011 – pas përfundimit të rindërtimit të më shumë se gjysmës së objekteve të dëmtuara.<sup>52</sup>

Përfundimisht, aktorët tjerë të angazhuar në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore janë edhe Policia e Kosovës<sup>53</sup>, Asociacioni i Komunave të Kosovës<sup>54</sup>, komunat<sup>55</sup> si dhe shoqëria civile.

Derisa ka mjaft palë të përfshira në fushën e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, në gjithë Ligjin për Trashëgimi Kulturore, e edhe aktet nënligjore të tij, përdoret vetëm termi “institucioni kompetent”, në vend se të emërohet agjencia specifike. Në kohën e hartimit të Ligjit, sipas MKRS-së, kjo dykuptimësi ishte lënë për të mundësuar ndryshimet e domosdoshme në strukturat administrative dhe institucionale që duhej të ndodhnin.<sup>56</sup> Megjithatë, Ligji prapë nuk definon se cilat institucione përgjegjëse janë kompetente, gjë që krijon paqartësi ligjore, derisa përgjegjësitë e këtyre institucioneve mbeten të padefinuara mirë dhe të hapura për interpretim. Përkundër natyrës ndërsektorale të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, bashkëpunimi

ndërmjet institucioneve lokale dhe qendrore, por edhe ndërmjet drejtorive të ndryshme komunale dhe ministrive të linjës, mbetet i kufizuar<sup>57</sup>. Më tutje, mungojnë edhe mekanizmi i qartë i bashkërendimit dhe forumi i rregullt i këmbimit të informatave për palët e përfshira që punojnë në çështje të trashëgimisë kulturore, derisa takimet ad hoc mbesin kryesisht e vetmja mënyrë e komunikimit mes këtyre aktorëve. Zakonisht, shumica e kontakteve bëhen ndërmjet QRTK-ve dhe komunave gjatë procesit të planifikimit hapësinor, derisa kontaktet ndërmjet Kishës Ortodokse Serbe dhe komunave kryesisht varen nga çështjet shqetësuese për të dyja palët, si ndërtimet ilegale brenda apo afër objekteve të Kishës Ortodokse Serbe, ose projektet në vazhdim.

Në përgjithësi, mund të përfundohet që korniza ligjore e Kosovës për mbrojtje të trashëgimisë kulturore gjerësisht është në përputhje me standardet përkatëse të të drejtave të njeriut. Megjithatë, dështimi në caktimin e përgjegjësive të veçanta për bartësit e veçantë të përgjegjësive ka penguar implementimin efektiv të zotimeve që merren përsipër me kornizën ligjore. OSBE-ja fuqimisht avokon që të trajtohen dykuptimësitë e tilla gjatë procesit të vazhdueshëm të ndryshim/plotësimit.



---

# 3. BRENGAT E PËRGJITHSHME NË MBROJTJEN E TRASHËGIMISË KULTURORE

---

## 3.1 Inventarizimi i pasurive të trashëgimisë kulturore

Inventarizimi është parakusht për ruajtjen dhe mbrojtjen e objekteve të trashëgimisë kulturore. Inventarët e objekteve të trashëgimisë kulturore të kategorive të ndryshme ofrojnë informata të harmonizuara, të krahasueshme dhe të dobishme për trashëgiminë, si dhe si të tilla, janë pjesë përbërëse e sistemit të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore. Përgatitja e inventarit është aktivitet i hulumtimit zyrtar për regjistrimin paraprak dhe dokumentimin e objekteve të trashëgimisë kulturore. Kështu ofrohet baza e vlerësimit nëse një objekt duhet mbrojtur ligjërisht apo jo, për të siguruar vlerën e tij përmes hartimit të një plani konservues.<sup>58</sup> Inventarët duhen ndërtuar për kategori të ndryshme të trashëgimisë kulturore, ku inventari për objekte të paluajtshme materiale të trashëgimisë kulturore në Kosovë duhet të përmbajë “monumentet, komplekset ndërtimore, zonat e konservimit arkitektonik, komplekset arkeologjike, rezervatet arkeologjike dhe peizazhet kulturore”.<sup>59</sup>

Ligji për Trashëgiminë Kulturore parasheh që MKRS, si institucioni kompetent, ta identifikojë trashëgiminë kulturore përmes një procesi të inventarizimit<sup>60</sup>. Ligji për Trashëgiminë Kulturore më tutje përcakton që nga ky inventar MKRS duhet t'i zgjedhë objektet që duhen futur në një listë të trashëgimisë kulturore nën mbrojtje të përkohshme prej një viti. Pastaj, MKRS duhet t'i propozojë objektet e trashëgimisë kulturore që duhen vendosur nën mbrojtje të përhershme tek KKTK-ja për shqyrtim, miratim apo refuzim.<sup>61</sup> Vijimisht, Ministri për Kulturë, Rini e Sporte nënshkruan listën e trashëgimisë kulturore nën mbrojtje të veçantë. Kjo listë e trashëgimisë kulturore nën mbrojtje të përhershme duhet të jetë e

hapur për publikun.<sup>62</sup>

Që prej shpalljes së Ligjit për Trashëgimi Kulturore në nëntor të vitit 2006, përpjekjet avokuese të palëve ndërkombëtare, duke përfshirë këtu OSBE-në, për zhvillimin e një inventari gjithëpërfshirës, kanë mbetur të pasuksesshme, pasi që MKRS-ja ende nuk ka siguruar inventarin e trashëgimisë kulturore për mbrojtje. Arsyet që kanë shkaktuar këtë vonesë, sipas MKRS-së, janë mungesa e personelit me aftësitë e duhura si dhe mungesa e burimeve financiare për të kryer procesin e inventarizimit.<sup>63</sup> Së fundmi, është bërë përparim nga MKRS-ja në këtë kuptim. OSBE-ja është informuar<sup>64</sup> që MKRS-ja ka përgatitur një bazë të dhënash për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore materiale (por ende jo të trashëgimisë kulturore shpirtërore apo materiale). Sipas MKRS-së, kjo bazë e të dhënave do të jetë e qasshme për publikun deri në fund të marsit 2014<sup>65</sup>.

Këshilli i Evropës, në kuadër të Programit të përbashkët të Bashkimit Evropian/Këshillit të Evropës të quajtur Mbështetja e Promovimit të Diversitetit Kulturor në Kosovë (PDKK), e ka mbështetur zhvillimin e udhëzimeve për inventarizimin e pasurive të trashëgimisë kulturore në Kosovë. Pas kësaj nisme, në vitin 2011, MKRS e ka përgatitur një listë të vendeve të mbrojtura të trashëgimisë kulturore e cila kishte përfshirë 930 vende arkeologjike dhe arkitekturore. Kjo listë është përditësuar dy herë (herën e fundit më 1 tetor 2013) dhe tani përfshin 1,428 vende. Ky është viti i tretë në të cilin MKRS-ja e ka nxjerrë listën e pasurive të trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përkohshme pa bërë vlerësim përcjellës për të përcaktuar se



---

cilat vende do të futen nën mbrojtje të përhershme. Kjo bie ndesh me Ligjin për trashëgiminë kulturore, pasi që ato pasuri duhet të vendosen në mbrojtje të përkohshme vetëm për një vit<sup>66</sup>. Nuk është e qartë se çfarë masash konkrete i përfshinë mbrojtja, çfarë kriteresh zbatohen për të përcaktuar nëse këto vende janë prioritet për MKRS-në, dhe cilat do të

vendosen në listën e mbrojtjes se përhershme.

MKRS-ja ende nuk e ka bërë një inventarizim gjithëpërfshirës të pasurive materiale të trashëgimisë kulturore në Kosovë dhe një listë të pasurive të trashëgimisë kulturore që janë në mbrojtje të përhershme.

## 3.2 Planifikimi Hapësinor

Ndonëse ende nuk ka ndonjë inventarizim të miratuar që i përcakton emrat e vendeve të trashëgimisë kulturore që do të mbrohen dhe ruhen, 45 manastire ortodokse serbe, kisha dhe vende tjera fetare, historike dhe kulturore me rëndësi specifike për komunitetin serb të Kosovës si dhe për komunitetet

tjera në Kosovë janë shpallur si ZVM në bazë të Ligjit për zonat e veçanta të mbrojtura.<sup>67</sup> Këto janë përkufizuar si “zonë e përcaktuar me hartë, ose me një zonë të përcaktuar që rrethon një monument, ndërtesë, grup ndërtesash, tërësi, fshat, ose qendër historike të qytetit që mbrohet nga çdo zhvillim



*Kalaja e Novobërdës*

---

apo aktivitet i cili mund të dëmtojë kontekstin e tij historik, kulturor, arkitekturor apo arkeologjik, mjedisin natyror apo kuadrin vizual estetik”.<sup>68</sup>

Objektivat e përcaktimit të zonave si ZMV janë: a) të sigurojnë ekzistencën dhe funksionimin paqësor të vendeve që do të mbrohen dhe të ruajnë mënyrën monastike të jetesës së klerikëve; b) të ruajnë karakterin dhe pamjen e vendeve që do të mbrohen, në veçanti, kontekstin historik, kulturor, arkitekturor dhe arkeologjik, mjedisin natyror dhe kornizën vizuale estetike; dhe c) të parandalojnë zhvillimet e pafavorshme rreth vendeve që duhet të mbrohen, ndërkohë që sigurojnë kushtet më të mira të mundshme për zhvillimin e harmonizuar dhe të qëndrueshëm të komuniteteve që banojnë në zonat rreth këtyre vendeve duke rregulluar zhvillimin dhe aktivitetet e tjera.<sup>69</sup>

Në këtë aspekt, disa aktivitete janë kufizuar me interesin publik për të ruajtur trashëgiminë kulturore dhe fetare. Derisa disa aktivitete janë shprehimisht të ndalura tjerat janë kushtëzuar me plotësimin e kritereve. Sipas Ligjit për zonat e veçanta të mbrojtura, 41 objektet e Kishës ortodokse serbe, për të cilat janë krijuar ZMV, e gëzojnë atë nivel të mbrojtjes ku ndalohet ndërtimi industrial, derisa urbanizimi i tokës bujqësore mund të lejohet vetëm me lejen e Kishës ortodokse serbe. Procedura e përdorur për të kërkuar pëlqim nga Kisha Ortodokse Serbe dhe afatet kohore brenda së cilave Kisha Ortodokse Serbe duhet të japë pëlqimin e saj nuk janë përkufizuar, gjë që lë hapësirë për veprime arbitrare dhe vonesa. Për aktivitete brenda katër objekteve jofetare të përfshira në Ligjin për zonat e veçantat të mbrojtura, kërkohet miratimi i KZM-së. Udhëzimi administrativ për KZM-në është shumë i qartë kur kemi të bëjmë me afatin brenda të cilit KZM-ja duhet të përgjigjet në kërkesat që i pranon.<sup>70</sup> Mirëpo, integrimi i të gjitha ZMV-ve në planet lokale të planifikimit hapësinor, p.sh. Planet zhvillimore komunale (PZHK), planet zhvillimore urbane (PZHU) dhe planet rregullative urbane, nuk ka përfunduar ende.

Legjislacioni për trashëgiminë kulturore parasheh masa të zoonimit për kontrollimin e shfrytëzimit të pronave dhe ndalimin e aktiviteteve të caktuara të cilat e dëmtojnë mjedisin apo e pengojnë jetesën monastike në këto vende, siç është ndërtimi industrial. Kufizimi për shfrytëzimin e pronës nuk

është absolut, por kufizimi duhet të jetë i nevojshëm për arritjen e qëllimit të synuar. – në këtë rast mbrojtja e trashëgimisë kulturore. Andaj, perimetri i ZMV-ve, kushtet që vlejné për to dhe zbatimi i tyre duhet të sigurojnë si mbrojtje efektive të trashëgimisë kulturore dhe fetare ashtu edhe zhvillim të qëndrueshëm dhe të drejta të pronës private të komuniteteve fqinjë. Kjo kërkon balancim të kujdesshëm të të drejtave individuale dhe konsiderata të interesit publik. Andaj, me qëllim të shmangies së pasojave negative, standardet e planifikimit hapësinor kërkojnë që bashkësitë e prekura të konsultohen në mënyrë të sinqertë si në fazën e hartimit të legjislacionit ashtu edhe në dizajnimin e perimetrit të zonave, dhe kërkon që kufizimet e zonave t’i nënshtrohen ligjeve për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave përkatëse.

Derisa Plani Hapësinor i Kosovës 2012-2020<sup>71</sup> paraqet një kornizë strategjike për ruajtjen e integruar të trashëgimisë kulturore, përfshirë 45 ZMV-të, integrimi i vendeve të trashëgimisë kulturore në planet hapësinore mbetet çështje shqetësuese. Jo të gjitha komunat i kanë miratuar planet hapësinore komunale të cilat janë esenciale për rregullimin e ndërtimit dhe zhvillimit përreth ZMV-ve dhe vendeve tjera të trashëgimisë kulturore. Shumë komuna janë aktualisht në proces të hartimit apo miratimit të PZHK-ve dhe sipas raportimeve do t’i përfshijnë ZMV-të dhe/apo vendet e trashëgimisë kulturore brenda territorit të tyre në këto plane. Për shembull, ndonëse nuk ka asnjë ZMV në Kamenicë, komuna i ka identifikuar disa vende të mundshme për mbrojtje, si kisha, varreza dhe teqe<sup>72</sup>, dhe i ka përfshirë ato në projekt PZHK-të e tyre. Disa komuna, si ajo e Pejës dhe Lipjanit tashmë i kishin miratuar PZHK-të e tyre para shpalljes së Ligjit për zonat e veçanta të mbrojtura. Andaj, ndonëse PZHK-ja fillestare nga viti 2007<sup>73</sup> tashmë e kishte paraparë Patriarkanën e Pejës si “zonë e mbrojtur”, për të qenë në përputhje me legjislacionin relevant<sup>74</sup>, Kuvendi komunal i Pejës e ka miratuar një ndryshim/plotësim të PZHK-së i cili i referohet mbrojtjes të cilën e gëzon vendi sipas Ligjit për zonat e veçanta të mbrojtura<sup>75</sup>. Vlen të përmendet që disa komuna që i kanë miratuar PZHK-të dhe/apo PZHU-të<sup>76</sup> iu janë referuar jo vetëm ZMV-ve por edhe vendeve tjera të trashëgimisë kulturore në territorin e tyre. Për shembull, komuna e Prishtinës e ka përfshirë “Zonën historike të Prishtinës” në PZHU (dhe është përmendur edhe në PZHK) si zonë për restaurim dhe ruajtje, e cila mbulon shumicën e qendrës së



qytetit<sup>77</sup>. Mirëpo, në kundërshtim me nenin 13 të Ligjit për planifikim hapësinor, PZHK-ja nuk është miratuar nga zyrtarët e MMPH-së<sup>78</sup>.

Komuna e Prizrenit e ka miratuar PZHK-në e saj në shtator të vitit 2013, i cili përmban disa deklaratë të përgjithshme përkitazi me mbrojtjen dhe zhvillimin e trashëgimisë kulturore dhe fetare dhe i referohet të gjithë legjislacionit në fuqi. Mirëpo, mbrojtja e ZMV-ve tjera nga ato që gjenden brenda Qendrës historike të qytetit të Prizrenit nuk është përmendur shprehimisht në PZHK.

Komuna e Deçanit e ka miratuar PZHK-në dhe PZHU-në në vitin 2009 dhe që të dy planet i referohen, ndër të tjera, vendeve si, Manastiri i Deçanit dhe mbrojtja që ato e gëzojnë në bazë të Ligjit për zonat e veçanta të mbrojtura. Mirëpo, planet ende përmbajnë referencë lidhur me rrugën e propozuar për Mal të Zi, një pjesë e së cilës është paraparë të kalojë afër ZVM-së. Rruga ishte planifikuar që të ndërtohet në vitin 2007, mirëpo, pas mospajtimeve të bashkësisë ndërkombëtare, Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit e kishte tërhequr tenderin. Sipas përfaqësuesve të Kishës Ortodokse Serbe, referenca në këtë rrugë në PZHK-në dhe PZHU-në e miratuar perceptohet si kërcënim ndaj regjimit të mbrojtjes së veçantë. Vendi garantohet me Ligjin për zonat e veçanta të mbrojtura, i cili e cekë ndërtimin e rrugëve transit në zonat rurale si aktivitet të ndaluar<sup>79</sup>. Për më tepër, kjo rrugë është ende e paraparë në Planin Hapësinor të Kosovës<sup>80</sup> ndonëse ZVM-ja e Manastirit të Deçanit

është përmendur njëkohësisht si “Zonë me interes të veçantë” në këtë dokument<sup>81</sup>.

Së voni, edhe komuna e Lipjanit e ka rishikuar PZHK-në dhe PZHU-në e saj për të përfshirë ZVM-në përreth Kishës së Shpalljes së Virgjëreshës.<sup>82</sup> Drejtori i urbanizmit e ka konfirmuar që ZVM-ja është integruar në planet e ndryshuara pa ndonjë zhvillim të pafavorshëm apo pa lejim të ndonjë aktiviteti të ndërtimit brenda zonës së përvijuar si ZVM.<sup>83</sup> Gjatë procesit të miratimit të PZHK-së dhe PZHU-së, Kisha Ortodokse Serbe dhe drejtori komunal i urbanizmit kanë punuar së bashku në bashkëpunim me kompaninë e planifikimit të kontraktuar nga komuna për hartimin e planeve.<sup>84</sup> Ndërtimi i paligjshëm i një depoje komerciale brenda ZVM-së në fillim të vitit 2013 e ka vënë në pah nevojën për një bashkëpunim të tillë<sup>85</sup>.

Siç është diskutuar, plani rregullator specifik për ZVM-të, i hartuar në pajtim me Ligjin për zonat e veçanta të mbrojtura, do të mundësojë përgjigje më të shpejtë ndaj kërkesave të qytetarëve për nxjerrjen e lejeve të ndërtimit brenda ZVM-ve dhe do të shmang kontestet e mëtutjeshme lidhur me ndërtimet pa leje. Përfshirja e ZVM-ve në këtë proces, do të ndihmojë në shmangien e kontesteve të tilla në të ardhmen. Ky bashkëpunim, mund të shërbejë si praktikë më e mirë edhe për komunat tjera me qëllim të përmirësimit të bashkëpunimit me Kishën Ortodokse Serbe në procesin e planifikimit hapësinor i cili i prekë ZVM-të.

### 3.3 Inspektimi i vendeve të trashëgimisë kulturore

Mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe fetare kërkon inspektim të rregullt nga institucionet publike. Korniza ligjore parasheh dy lloje të inspektimit të vendeve të trashëgimisë kulturore:

1. Inspektimin që bëhet nga niveli komunal; dhe
2. Inspektimin që bëhet nga MKRS-ja.

Sipas ligjit për ndërtimet, inspektorët ndërtimorë komunalë janë të obliguar për të raportuar në nivel qendror çdo ndërtim të vërejtur në vendet e

trashëgimisë kulturore.<sup>86</sup> Mirëpo, OSBE-ja është e brengosur, siç demonstrojnë shembujt e mëposhtëm, që komunat shpesh, me sa duket, kanë mungesë të inspektorëve të kualifikuar për vlerësimin e mbrojtjes së vendeve të trashëgimisë kulturore dhe burimet e nevojshme për trajnimin e inspektorëve ekzistues.

Në lidhje me çështjen e inspektimeve të kryera nga MKRS-ja, është nxjerrë një rregullore<sup>87</sup> e cila, ndër të tjera, i vendosë standardet minimale dhe procedurat për inspektim, mbikëqyrje të çfarëdo ndërtimi relevant nga MKRS-ja<sup>88</sup>. Sipas drejtorit të Departamentit për



*Kisha e shën Kirijakut*

trashëgimi kulturore pranë MKRS-së<sup>89</sup>, QRTK-të (si pjesë e strukturës së MKRS-së) duhet që të bëjnë inspektime në emër të MKRS-së. Mirëpo QRTK-të ende nuk kanë inspektorë të specializuar për të bërë inspektim të objekteve të trashëgimisë kulturore dhe fetare.

Një shembull i vështirësive të hasura në rastet kur nuk bëhen inspektime nga MKRS, është i evident nga rasti i fundit i përgatitjes së listës së pasurive të trashëgimisë kulturore për mbrojtje të përkohshme. Lista më e fundit nuk i përfshinë 77 pasuri të trashëgimisë kulturore që gjenden në listën e mëhershme nga viti 2012<sup>90</sup>. Këto 77 pasuri të trashëgimisë kulturore kryesisht përbëhen nga shtëpi nga koha otomane, mullinjtë të vjetër etj. që gjenden kryesisht në pjesën perëndimore të Kosovës. Sipas MKRS-së, pasuritë janë larguar nga lista aktuale për shkak të “humbjes së vlerës” si rezultat i dëmtimit dhe mungesës së mirëmbajtjes. Shumë nga pasuritë e trashëgimisë kulturore të numëruara në vitin 2012 tashmë ishin dëmtuar rëndë

apo shkatërruar, kryesisht për shkak të mungesës së mirëmbajtjes, dhe mund të mos jenë inspektuar në kohën e përgatitjes së listës. Në disa raste, pronarët e atyre pronave tashmë i kishin shembur pasuritë e trashëgimisë kulturore me qëllim që të nisnin ndërtime të reja, gjë që përbën vepër të kundërligjshme në bazë të Ligjit për trashëgiminë kulturore<sup>91</sup> por që ende mbeten të pasanksionuar edhe sot e kësaj dite<sup>92</sup>.

Përveç kësaj, as inspektoratet komunale e as QRTK-të nuk kanë plane të hartuara për inspektimet e rregullta në vendet e trashëgimisë kulturore. Mirëpo, inspektimet bëhen në baza ad hoc kur aktivitetet negative tashmë kanë ndodhur, në vend të inspektimeve sipas detyrës zyrtare (parandaluese) që do të ndërmerreshin për minimizimin e dëmit ndaj vendeve të trashëgimisë kulturore duke i rritur kështu gjasat për identifikimin e dëmtimeve në fazat e hershme dhe kthimin e tyre në gjendje të mëparshme<sup>93</sup>.




Një shembull i kësaj janë punimet e paautorizuara të gërmimit që i kanë rrezikuar themelet e kishës Shën Kyriake<sup>94</sup> që gjendet në qendrën historike të qytetit të Prizrenit. Në maj të vitit 2011, një pronar shqiptar i Kosovës kishte filluar punimet e gërmimit në pronën e tij që gjendet ngjitur me kishën. Pas ankesës nga Kisha Ortodokse në Policinë e Kosovës, inspektori ndërtimor komunal e kishte vizituar vendin në po të njëjtën ditë dhe e kishte urdhëruar ndërprerjen e punëve, mirëpo themeli i kishës tashmë ishte rrezikuar. Siç është sqaruar nga komuna<sup>95</sup>, zyra e urbanizmit e kishte autorizuar pronarit vetëm për “pastrimin e vendit” e jo për gërmim. Sikur inspektori komunal të kishte kryer inspektime të rregullta të vendit, do të mund të parandaloheshin kjo ngjarje negative. Ajo që më së paku do të mund të bënte inspektori komunal është që në mënyrë proaktive ta vizitonte vendin pas lëshimit të lejes së ndërtimit, për t’u siguruar që kushtet e saj janë duke u respektuar, në vend se të presë që një herë t’i vijë ndonjë ankesë nga Kisha Ortodokse Serbe dhe pastaj të reagojë.

Një shembull i mëvonshëm i ndërtimit pa leje ka ndodhur në Manastirin e Deçanit në rajonin e Pejës. Një urë e drurit është ndërtuar afër Manastirit pa pëlqimin e Kishës Ortodokse Serbe. Personi i cili e kishte ndërtuar urën (i cili me sa duket ishte pronar i tokës) nuk kishte kërkuar ndonjë leje e as nuk kishte shkuar fare në drejtorinë e urbanizmit në asnjërën fazë të ndërtimit<sup>96</sup>. Vetëm pas vizitës nga inspektori komunal<sup>97</sup> pronari kishte parashtruar kërkesë në drejtorinë për urbanizëm për ndërtim të urës. Inspektimet e rregullta në ZVM nga inspektorët komunal siç është rasti në Manastirin e Deçanit, kanë mundur ta sjellin ndërtimin pa leje në vëmendjen e komunës në faza të mëhershme dhe do të mundësonin respektimin e procedurave të duhura (përfshirë marrjen e pëlqimit nga Kisha Ortodokse Serbe)<sup>98</sup>.

Ndërtimet e mëtutjeshme të pakontrolluara mbesin shqetësim që prekë vendet e trashëgimisë kulturore në Kosovë. Aktivitetet e ndërtimeve pa leje vazhdojnë të ndodhin nëpër ZVM, si ndërtimi i depove afër monumentit të Gazimestanit në komunën e Obiliqit dhe afër Kishës së Shpalljes së Virgjëreshës në komunën e Lipjanit. Ndërmjet vitit 2009 dhe 2011, QRTK i ka adresuar rreth 50 raste të ndërtimeve pa leje dhe/apo ndërtimeve të pakontrolluara<sup>99</sup> brenda qendrës historike të komunës së Prizrenit<sup>100</sup>.

Përveç marrjes së lejeve të ndërtimit të lëshuara nga komuna, çdo ndërtim brenda Qendrës Historike të Prizrenit kërkon autorizimin përfundimtar/pëlqimin e QRTK-së. Pavarësisht kësaj, në shumicën e rasteve parametrat e vendosur në pëlqimin e dhënë nga QRTK nuk respektohen dhe inspektorët ndërtimor komunal dështojnë të intervenojnë.

Si zhvillim pozitiv mund të përmendet se KZM i ka trajtuar disa raste të ndërtimit të paligjshëm përbrenda ose në afërsi të ZVM-ve dhe ka pasur ca rezultate pozitive. Një shembull i tillë ka të bëjë me ZVM-në e Kishës së Shpalljes së Virgjëreshës në Lipjan<sup>101</sup>. Në janar të vitit 2013, pronari i një prone fqinje filloi që në mënyrë të paligjshme të ndërtojë një depo brenda vijës kufizuese të ZVM-së, duke shkuar përtej vijës ndërtimore të përcaktuar në lejen



*Monumenti i Gazimestanit*

për ndërtim të nxjerrë nga komuna<sup>102</sup>. Më 13 gusht 2013, Sekretaria e KZM-së i drejtoi MMPH-së një kërkesë për shembjen e ndërtimit të paligjshëm<sup>103</sup>. Si rrjedhojë, pas inspektimit të pronës në fjalë drejtori i Inspektoratit të MMPH-së urdhëroi më 15 gusht 2013 inspektoratin komunal që menjëherë ta ndalojë ushtrimin e veprimtarisë afariste dhe të shkatërrojë depon e vendosur brenda ZVM-së, gjë që edhe ndodhi në fund të gushtit të vitit 2013<sup>104</sup>.

Edhe MKRS-ja ka vepruar gjithashtu për të siguruar ndërprerjen e veprimtarive që cenonin trashëgiminë kulturore nën mbrojtje. Për shembull, komuna e Gjakovës kishte filluar punët e ndërtimit, duke përfshirë këtu edhe zëvendësimin e kalldrëmit të vjetër, në hapësirën e trashëgimisë së kulturore nën mbrojtje të Çarshisë së Madhe (Pazari i Vjetër). Por, komuna i kishte ndërmarrë këto veprime pa e marrë më parë pëlqimin e QRTK-së. Pas protestave publike të pronarëve të dyqaneve të prekur nga punimet, më 5 nëntor 2012, MKRS nxori vendim për ndërprerjen e menjëhershme të punëve të ndërtimit. Më 27 dhjetor 2012, Ministri nxori një vendim të

dytë që lejonte vazhdimin e punimeve të ndërtimit, përveç zëvendësimit të kalldrëmit, si edhe kërkonte mbikëqyrje të drejtpërdrejtë nga QKRT dhe obligonte komunën që të jepte tri projekte ideore për kalldrëmin.

Veç kësaj, në pranverë të vitit 2013, në afërsi të Manastirit të Deçanit u ndërtua një hurdhë peshqish me pëlqim të Manastirit dhe pasi që aplikuesi ishte pajisur me gjithë lejet dhe pëlqimet e nevojshme.<sup>105</sup> Drejtori i urbanizmit e konsideron këtë si shembull pozitiv që duhet të ndiqet edhe në rastet tjera. Kjo çështje u diskutua shkurtimisht nga KZM, me ç' rast u konstatua që hurdha e peshqve ishte ndërtuar pas marrjes së pëlqimit nga Manastiri i Deçanit.<sup>106</sup>

Për të qenë në gjendje që ta mbrojnë më mirë trashëgiminë kulturore, MKRS dhe organizmat gjegjës tjerë duhet të kërkojnë rrugë qoftë për t'ia deleguar inspektimin e trashëgimisë kulturore në mënyrë të qartë nivelit lokal dhe për të siguruar aftësimin profesional të personelit, apo për t'i angazhuar më tepër institucionet qendrore kur është fjala për vizitat/inspektimet në terren.



Çarshia e Madhe

---

# 4. SHQETËSIMË SHITESË LIDHUR ME MBROJTJEN E TRASHËGIMISË SË KOMUNITETEVE JOSHQIPTARE

---

## 4.1 Masat e sigurisë dhe mbrojtjes

Për t'i përmbushur detyrimet e tyre në garantimin e të drejtave të njeriut, institucionet jo vetëm që duhet të përmbahen nga ndërhyrja në gëzimin e të drejtave kulturore nga të gjithë personat, por që t'i parandalojnë edhe individët dhe grupet private nga pengimi i gëzimit të të drejtave kulturore të të tjerëve, përfshirë të drejtën për qasje dhe dobi nga trashëgimia kulturore<sup>107</sup>. Gjatë konfliktit, dhe menjëherë pas përfundimit të tij, në Kosovë u shkatërruan shumë objekte të trashëgimisë kulturore. Objektet e Kishës Ortodokse Serbe ishin shënjestër e dhunës me motive etnike gjatë trazirave të marsit të vitit 2004, gjë që çoi në dëmtimin e rëndë të kishave dhe manastireve të Kishës Ortodokse Serbe. Tani kërcënim ndaj sigurisë së objekteve të trashëgimisë kulturore përbëjnë kryesisht rastet e vandalizmit dhe vjedhjeve<sup>108</sup>.

Derisa në të kaluarën shumica e objekteve të Kishës Ortodokse Serbe ishin nën mbrojtjen e Forcës së NATO-s në Kosovë (KFOR-it) ose rojeve private të sigurimit të punësuar nga MKRS-ja, tani mbrojtja nga ana e Policisë së Kosovës është element kyç në garantimin e sigurisë fizike të këtyre vendeve. Që nga shkurti i vitit 2009, Policia e Kosovës po zbaton një urdhër operativ me udhëzime të hollësishme rreth ofrimit të sigurisë për objektet e trashëgimisë fetare dhe kulturore ortodokse serbe<sup>109</sup>. Në fillim, urdhri operativ përfshinte 17 objekte të Kishës Ortodokse Serbe që konsideroheshin si më të rrezikuarat. Në

vitin 2011, Policia e Kosovës bëri një analizë bazë dhe duke e marrë atë si pikënisje i shtoi gradualisht urdhrin operativ edhe shumë objekte të tjera të trashëgimisë kulturore. Veç kësaj, mes 2009-ës dhe 2011-ës, d.m.th pas nxjerrjes së urdhrin të parë, KFOR-i ia barti Policisë së Kosovës përgjegjësinë për mbrojtjen e tetë objekteve të tjera<sup>110</sup>, ndërsa në prill të vitit 2012 nën përgjegjësinë e Policisë së Kosovës kaloi edhe një objekt tjetër<sup>111</sup>. Në gusht të vitit 2013, Policia e Kosovës mori përgjegjësi të plotë për sigurimin e Patriarkanës së Pejës, pas zvogëlimit gradual të pranisë së KFOR-it në atë vend. Tani nën mbrojtje të KFOR-it ka mbetur vetëm një objekt<sup>112</sup>. Në mënyrë të veçantë, përveç kompleksit arkeologjik të Ulpianës të cilin Policia e Kosovës e pati përfshirë në skemën e mbrojtjes 24-orëshe nga viti 2009 deri 2012, nën mbrojtje janë vetëm objektet e Kishës Ortodokse Serbe dhe objekteve të trashëgimisë së serbëve të Kosovës.<sup>113</sup>

Sipas Policisë së Kosovës, në vitet 2011, 2012 dhe 2013 ka pasur shtim të numrit të incidenteve të sigurisë në vendet e trashëgimisë kulturore<sup>114</sup>, në krahasim me vitet e mëparshme kur ishte vërejtur një trend i zvogëlimit të incidenteve (shih grafikun 1). Shtimi i numrit të incidenteve të sigurisë prek në veçanti trashëgiminë e Kishës Ortodokse Serbe. Në vitin 2011, Policia e Kosovës ka regjistruar gjithsej 55 incidente të sigurisë ndaj vendeve të trashëgimisë kulturore dhe fetare, 16 nga të cilat




kanë prekur objekte nën mbrojtje sipas urdhrit operativ.<sup>115</sup> Nga këto 16 incidente, dy kanë ngjarë në vende që janë nën mbrojtje 24-orëshe nga ana e Policisë së Kosovës.<sup>116</sup> Në vitin 2012, nga gjithsej 57 incidente<sup>117</sup>, 36 (63 për qind) kanë prekur objekte të trashëgimisë së Kishës Ortodokse Serbe, ndërsa në vitin 2013 nga gjithsej 87 incidente, 41 (47 për qind) kanë prekur objektet e trashëgimisë së Kishës Ortodokse Serbe.

me atë të vitit 2011.

Ndonëse numri i incidenteve të sigurisë është rritur në mënyrë të konsiderueshme gjatë vitit 2013, OSBE-ja ka vërejtur përmes monitorimit të saj që një rritje aq e madhe ishte kryesisht rrjedhojë e një rritjeje të rasteve të motivuara ekonomikisht të vjedhjes së kishave (këto incidente janë klasifikuar ose si vjedhje ose si dëmtim i objekteve fetare). Përveç kësaj,

Grafiku 1



Burimi: Policia e Kosovës

Duke u bazuar në aktivitetet monitoruese të OSBE-së, që përfshijnë intervista me zyrtarë të Kishës Ortodokse Serbe, zyrtarë të Policisë së Kosovës dhe përfaqësues të komunitetit, Policia e Kosovës ka kryer vlerësime të rregullta të rrezikut në të gjitha vendet e përfshira në urdhrin operativ dhe duket sikur e përmbushë protokollin për mbrojtjen e objekteve të trashëgimisë kulturore të Kishës Ortodokse Serbe. Gjithashtu, duke qenë se në vitin 2011 janë rritur rastet e vjedhjes dhe vandalizmit të objekteve të trashëgimisë krahasuar me vitin 2009 dhe 2010, Policia e Kosovës për rrjedhojë ka shtuar numrin e patrullimeve në ato vende që nuk janë të siguruar 24 orë. Sidoqoftë, numri i vjedhjeve dhe akteve të vandalizmit në vitin 2012 ka mbetur i njëjtë

vetëm gjatë muajit janar të vitit 2013 kanë ngjarë dhjetë raste të raportuara të dëmtimit të varrezave të Kishës Ortodokse Serbe. Këto incidente janë konsideruar veprime të jashtëzakonshme të nxitura nga një ngjarje e veçantë, heqja e monumentit në nder të pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit (UÇPMB) të vrarë në konfliktin e periudhës 2000–2001.

Në mars të vitit 2013, Policia e Kosovës themeloi një njësi të specializuar për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe objekteve fetare, me katër nën-njësi të mbrojtjes së objekteve të Kishës Ortodokse Serbe në rajonet e Prishtinës, Mitrovicës/Mitrovica, Pejës dhe Prizrenit. Kjo njësi ofron mbrojtje





*Manastiri i Deçanit*

24-orëshe të vendeve të trashëgimisë kulturore të Kishës Ortodokse Serbe dhe serbëve të Kosovës, si dhe rregullisht patrullon e viziton 169 vende të trashëgimisë kulturore të Kishës Ortodokse Serbe. Për të siguruar që njësia e specializuar të mund të veprojë në mënyrë sa më efektive që të jetë e mundur, OSBE-ja ka organizuar tetë seanca trajnimi në tërë Kosovën. Diku rreth 170 policë janë trajnuar rreth kuadrit ligjor që rregullon trashëgiminë kulturore dhe fetare, përgjegjësitë e reja për policinë dhe qasjet në komunikimin me publikun dhe klerin<sup>18</sup>. Megjithatë, rritja e konsiderueshme e numrit të incidenteve të sigurisë që lidhen me vendet e trashëgimisë kulturore paraqet një trend shqetësues dhe mbetet të shihet se çfarë masash shtesë do të marrë Policia e Kosovës për të reaguar ndaj këtyre incidenteve.

Duke u bazuar në monitorimin e OSBE-së në terren dhe raportet e Policisë së Kosovës, shumica e incidenteve në vendet e trashëgimisë kulturore

duket të kenë qenë thyerje me dhunë dhe vjedhje të parave apo materialeve me vlerë. Edhe nëse nuk raportohet për motive etnike, incidentet e tilla kanë tendencë që të kenë ndikim negativ në perceptimet për siguri dhe liri të lëvizjes tek komunitet e prekura, në veçanti serbët e Kosovës. Ndikimi negativ në perceptim është edhe më i madh kur krimet kryhen në ato zona ku komuniteti i prekur në të kaluarën ka qenë cak i krimeve me motive etnike apo kur krimet ndodhin në një atmosferë të tensionuar, siç ka qenë rasti pas zhvillimeve në veri të Kosovës që nga korriku i vitit 2011.

Në lidhje me zbatimin, numri i arrestimeve/ndjekjeve penale nga ana e Policisë së Kosovës/gjyqësorit si përgjigje ndaj incidenteve të sigurisë është i ulët. Për shembull, në vitin 2012, nga gjithsej 36 incidente, Policia e Kosovës ka bërë vetëm 9 arrestime. Gjithashtu, OSBE-ja ka vërejtur gjatë monitorimit se kryerësit e shumicës së incidenteve që kanë prekur

vendet e trashëgimisë fetare dhe kulturore janë të panjohur dhe për këtë arsye nuk ka pasur gjykim të këtyre rasteve në gjykata. Megjithëse prokurorët kanë detyrimin për të përcjellë rregullisht ecurinë e hetimeve për dëmtim të objektit të trashëgimisë kulturore, ata shpesh dështojnë në këtë detyrë. Gjithashtu, OSBE-ja nuk ka regjistruar asnjë rast të ngritjes së aktakuzës ndaj kryerësve të cilët kanë ndërtuar në mënyrë të paligjshme në vendet e trashëgimisë kulturore apo lidhur me çfarëdolloj shkeljeje të Ligjit për ndërtim. Me gjithë këtë, numri i arrestimeve në vitin 2013 është rritur në gjithsej 27 persona të arrestuar.

Dy mekanizma përmes të cilëve komunat mund të adresojnë shqetësimet e sigurisë janë Këshillat Komunalë për Siguri në Bashkësi (KKSB)<sup>119</sup> dhe Komitetet Lokale për Siguri Publike (KLSP). Aty ku janë themeluar, KKSB-të janë organe kryesore komunale me mandatin për t'i adresuar çështjet e sigurisë të komuniteteve në pakicë numerike në një komunë të caktuar, përveç akterëve të zakonshëm të sigurisë dhe të drejtësisë sikurse Policia e Kosovës dhe gjyqësori<sup>120</sup>, ku përfshihen edhe incidentet e sigurisë në vende të trashëgimisë kulturore. Përveç katër komunave, gjithë komunat i kanë themeluar KKSB-të<sup>121</sup>; megjithatë, funksionimi efektiv i KKSB-ve ndryshon nga njëri vend në tjetrin. KLSP-të janë themeluar nga policia me kërkesë të komunitetit lokal<sup>122</sup> dhe janë mekanizëm për të zbatuar nisma të punës policore në bashkësi dhe për të përmirësuar sigurinë në bashkësi duke i mbledhur anëtarët e komunitetit lokal, policët, zyrtarët lokalë, përfaqësuesit e shkollave, gratë dhe të rinjtë. Ndonëse shumë komuna i kanë themeluar KLSP-të të cilët janë dëshmuar si shumë të dobishëm në drejtimin e veprimeve korigjuese në vendet e trashëgimisë kulturore<sup>123</sup>, ata janë vetëm mekanizma vullnetarë dhe performanca e tyre varet nga ajo nëse mbledhen rregullisht, nëse zyrtari i sektorit nga Policia e Kosovës merr pjesë në

takimet e tyre dhe nëse procesverbalet (ose gjetjet) e takimeve u raportohen komandantit të stacionit apo koordinatorit të punës policore në bashkësi. Disa KLSP i mbulojnë shumë fshatra në një sektor policor (me dy ose tri komunitete) dhe në shumë raste raportet me Policinë e Kosovës janë të dobëta dhe nuk ka reagim proaktiv e të strukturuar nga të dyja anët.

Megjithatë, një shembull pozitiv që e ka vënë re OSBE-ja ka qenë pagesa e dëmeve nga institucionet e Kosovës pas incidenteve të sigurisë nëpër objekte të Kishës Ortodokse Serbe. Në janar të vitit 2013, ndodhën një sërë sulmesh ndaj objekteve të trashëgimisë fetare dhe kulturore të Kishës Ortodokse Serbe<sup>124</sup>. Incidentet shkaktuan shqetësime serioze në mesin e komunitetit të serbëve të Kosovës anembanë Kosovës, madje edhe atyre që nuk kishin qenë në shënjestër të drejtpërdrejtë apo prona e të cilëve nuk ishte dëmtuar drejtpërdrejtë nga sulmet. Këto veprime u dënuan ashpër nga zyrtarë të lartë të nivelit lokal dhe qendror, si dhe nga OSBE-ja. Si reagim ndaj sulmeve, institucionet e Kosovës ndanë një shumë prej €97,000 për riparime<sup>125</sup>, shumë kjo që iu pagua Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL). Një OJQ lokale e quajtur "Raskrshqë" u përzgjedh dhe u kontraktua nga MAPL për të menaxhuar me riparimet dhe restaurimin e varrezave/gurëve të varreve të përdhosur. Të gjitha punët restauruese u kryen deri në korrik të vitit 2013<sup>126</sup>.

Sidoqoftë, OSBE-ja ka vërejtur gjithashtu se në përgjithësi reagimet komunale ndaj incidenteve të sigurisë, përfshirë këtu ato që kishin të bënin me vende të trashëgimisë kulturore kryesisht janë bërë në mënyrë ad hoc dhe pa ndonjë qasje të njëtrajtshme nga ana e komunave.<sup>127</sup> Pavarësisht motivit prapa këtyre incidenteve, kur komunat nuk reagojnë, perceptimet e pasigurisë rriten në mesin e komuniteteve të prekura.

## 4.2 Cenimi i të drejtave pronësore të Kishës Ortodokse Serbe

Përveç rasteve të vjedhjes dhe vandalizmit, trashëgimia kulturore në Kosovë, e sidomos ajo e Kishës Ortodokse Serbe, po kërcënohet edhe nga disa vendime komunale që nuk janë në përputhje me kuadrin ligjor i cili mbron trashëgiminë kulturore.

Një shembull i këtillë është ndërhyrja e komunës së Rahovecit në pronën e Manastirit të Zoqishtës<sup>128</sup>, duke gërmuar një pjesë të tokës së manastirit me qëllim të zgjerimit të një rruge lokale dhe duke krijuar kështu rrezik të rrëshqitjes së dheut që do të mund





*Patriarkana e Pejës*

të dëmtonte potencialisht varrezat brenda pronës së manastirit<sup>129</sup>. Komuna kreu matjet gjeodezike që konfirmuan ndërhyrjen e komunës dhe më pas pezulloi ndërtimin e rrugës deri në arritjen e një ujdie me Manastirin që do të ishte në dobi të të dyja palëve. Në një letër drejtuar autoriteteve kompetente të Kishës Ortodokse Serbe, komuna kërkoi pëlqimin e tyre për vazhdimin e punimeve dhe ofroi që si kompensim të ndërtonte një mur mbështetës përgjatë pronës së prekur të manastirit.<sup>130</sup> Peshkopi i Dioqezës së Rashkës së Prizrenit iu përgjigj letrës duke kërkuar që përveç murit mbështetës komuna të bënte edhe kompensim monetar për tokën e marrë<sup>131</sup>. Pas këtij letërkëmbimi, komuna vazhdoi me ndërtimin e rrugës, ndërkaq Kishës Ortodokse Serbe i ofroi si kompensim për “shpronësimin e pronës së manastirit që i është marrë me qëllim të ndërtimit dhe zgjerimit të rrugës publike” të drejtë pronësie për një pjesë të një parcele tjetër toke ngjitur me manastirin të cilën manastiri e përdorte

tashmë si zonë parkimi.<sup>132</sup> Ndërtimi i rrugës u krye në shtator të vitit 2011. Mirëpo, ndërtimi i murit mbështetës nuk filloi deri më 21 tetor 2013<sup>133</sup>.

Në këtë rast, komuna filloi punimet pa ndonjë marrëveshje me përfaqësuesit e Manastirit. Kjo shkel në mënyrë të qartë Ligjin për zonat e veçanta të mbrojtura<sup>134</sup>, meqë neni 7.1 i ligjit e klasifikon manastirin si ZVM dhe prandaj komuna do të duhej të kishte “kërkuar marrëveshjen e Kishës Ortodokse Serbe” para se të kryente çfarëdo aktiviteti që mund të ndërhynte në zonë dhe më pas t’ia referonte çështjen KZM-së për shqyrtim nëse marrëveshja nuk do të ishte arritur.<sup>135</sup> Privimi i manastirit nga prona në këtë rast përbën de facto shpronësim. Ky parim rikonfirmohet më tutje me Ligjin për shpronësim<sup>136</sup>. Ndërrimi i tokës i ofruar nga komuna ngrit një brengë shtesë. Në kohën e ndërrimit të tokës, legjislacioni i zbatueshëm nuk parashihte mundësi të ndërrimit të pronësisë me komunën dhe çfarëdo personi tjetër



---

fizik ose juridik<sup>137</sup>, prandaj dhe përshtatshmëria e ndërrimit të tokës së ofruar si kompensim duket se është në kundërshtim me obligimet ligjore të institucioneve të Kosovës në atë kohë.

Një ndërhyrje e tillë me të drejtat pronësore jashtë kornizës relevante ligjore ngre brenga serioze veçanërisht se, meqë ndërtimi i rrugës ka përfunduar, Manastiri është lënë në pozitë të cenueshme dhe ka gjasë që mos të ketë mundësi tjetër përveç asaj të pranimit të ofertës për ndërrim të tokës të bërë nga komuna. Fillimi i punimeve për ndërtimin e rrugës para përmbytjes të të gjitha obligimeve ligjore lidhur me mbrojtjen e ZVM-ve dhe obligimeve për kompensim sipas Ligjit për shpronësim të pronës së paluajtshme<sup>138</sup> mund të çojë në shkelje të rënda të së drejtave pronësore. Një marrëveshje e nënkuptuar ndërmjet palëve nuk është e mjaftueshme për t'ia tejkualuar për nga rëndësia përmbytjes së obligimeve ligjore. Vlen të përmendet, marrëveshja e arritur përbën më shumë zgjidhje politike se sa ligjore të rastit.

Në një rast tjetër, gjatë 2011 dhe 2012 komuna e Pejës zbatoi një projekt të financuar nga Bashkimi Evropian me fokus zhvillimin e turizmit në grykën e Rugovës, i cili parashihte zhvillimin e shtigjeve ekzistuese të çiklizmit dhe shtigjet për ecje, pjesë të të cilave shtriheshin në ZVM-në rreth Patriarkanës së Pejës. Zyrtarët komunalë i shkruan Patriarkanës së Pejës lidhur me projektin dhe kërkuan pëlqimin e tyre<sup>139</sup> në përputhje me Ligjin për zonat e veçanta të mbrojtura që kërkon nga komunat të marrin pëlqimin e Kishës Ortodokse Serbe para se të kryejnë çfarëdo aktiviteteve që mund të ndërhyjnë me zonën<sup>140</sup>. Megjithatë, Patriarkana u përgjigj negativisht në këtë kërkesë duke arsyetuar se projekti mund të rezultonte me rritje të numrit të individëve që kalojnë nëpër zonë, gjë kjo që do të mund të rrezikonte sigurinë e vendit. Për më tepër, Patriarkana vuri në pah se shtigjet ekzistuese gjenden brenda një zone

të pyllit ku ,në të kaluarën, komuna kishte dështuar të ndalojë prerjen e paligjshme pyjeve.<sup>141</sup> Rrjedhimisht, komuna ia referoi çështjen MKRS dhe KZM për të lehtësuar një zgjidhje,<sup>142</sup> ashtu siç kërkohet me nenin 6 të Ligji për zonat e veçanta të mbrojtura në raste kur ka pajtim ndërmjet palëve të përfshira. Lehtësuesi (bashkë-kryesuesi i KZM-së) mbajti disa takime me kryetarin e komunës dhe përfaqësuesit e Kishës Ortodokse Serbe për të gjetur një zgjidhje, por punimet nuk kishin ndaluar pavarësisht nga mosmarrëveshjet e vazhdueshme. Përderisa me kalimin e kohës Kisha Ortodokse Serbe pushoi kundërshtimet e saj kundër punëve që përfunduan më 2012, komuna shkeli qartë obligimet e saj sipas Ligjit për zonat e veçanta të mbrojtura meqë:

Komuna nuk kishte siguruar pëlqimin e qartë të Kishës Ortodokse Serbe para fillimit të projektit, duke shkelur kështu nenin 7.1 të Ligjit për zonat e veçanta në mbrojtje. Kjo është më shqetësuese në rrethanat ku ishte përfshirë shpronësimi i pronës private; dhe

Komuna vazhdoi me ndërtimin e projektit pavarësisht nga fakti se KZM nuk ia arriti të lehtësonte një marrëveshje me Kishën Ortodokse Serbe. Kjo është shkelje e nenit 6 të Ligjit për zonat e veçanta të mbrojtura.

Ndonëse komunikimi ndërmjet Kishës Ortodokse Serbe dhe komunat është përmirësuar dhe shtuar dukshëm gjatë pesë viteve të fundit<sup>143</sup>, shembujt e përmendur më sipër pasqyrojnë se ende ekziston nevoja për vendosjen e procedurave dhe afateve të qarta kohore për konsultime të komunave me Kishën Ortodokse Serbe për aktivitetet e ndaluara brenda ZVM-ve dhe përgjigjes së Kishës Ortodokse Serbe. Një brengë tjetër është që raste të tilla mund të nxisin veprime të ngjashme dhe për rrjedhim të rezultojnë në ndërhyrje tjera të paligjshme me pronat e Kishës Ortodokse Serbe edhe në komunat e tjera të Kosovës.

### 4.3 Promovimi i trashëgimisë kulturore

Përveç ruajtjes dhe restaurimit të vendeve të trashëgimisë kulturore, institucionet kanë edhe obligimin për promovimin trashëgiminë kulturore, qoftë përmes fushatave edukative ose të ngritjes së vetëdijes së publikut<sup>144</sup> për të drejtën për pjesëmarrje

në jetën kulturore dhe, me analogji, nevojën korresponduese të respektimit të trashëgimisë dhe diversitetit kulturor. Aktivitete të tilla promovuese do të ndihmonin në krijimin e kushteve që çojnë në raporte konstruktive ndërkulturore që bazohen në

---

respektin, kuptimin dhe tolerancën e ndërsjellë. Disa aktivitete të tilla të ndërmarra nga institucionet e Kosovës deri më sot përfshijnë pjesëmarrjen vjetore të MKRS-së në Ditët e Trashëgimisë Evropiane<sup>145</sup>, dhe themelimi i grupit ndërministror të punës për komunikim dhe zbatim të ZVM, organizimi i fushatës mbarë kosovare për kontaktim dhe publikimi i broshurës për Zonat e Mbrojtura<sup>146</sup> dhe ZVM-të në mars 2010. Veç kësaj, shumë komuna në rajonin e Pejës dhe Prizrenit kanë filluar të punojnë në menaxhimin e trashëgimisë kulturore. Plani i Trashëgimisë Kulturore Lokale në Prizren<sup>147</sup> mëton mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore, integrimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore në jetën bashkëkohore dhe zhvillimin lokal dhe edukojë, trajnojë dhe ngritë vetëdijen për trashëgiminë kulturore dhe natyrore. Këshilli i Evropës, si pjesë e një projekti të përbashkët me Bashkimin Evropian<sup>148</sup>, ka përkrahur gjashtë komuna në rajonin e Pejës për të themeluar një zyre për Promovimin e Menaxhimit të Trashëgimisë – West (PHM)<sup>149</sup>. Me këtë synohet të identifikohen strategjitë më të përshtatshme për t'i avancuar objektivat në kontekst të zhvillimit të komponentës së turizmit të qëndrueshëm kulturor në kuadër të strategjisë së përgjithshme të turizmit për rajonin. Veç kësaj, në fund të vitit 2012, MKRS themeloi divizionin për menaxhimin e integruar të trashëgimisë kulturore në kuadër të ministrisë me qëllim të zhvillimit të planeve të integruara të menaxhimit dhe forcimit të lidhjeve ndërmjet trashëgimisë kulturore dhe turizmit, megjithatë aktivitetet e këtij divizioni gjatë 2013 ishin minimale<sup>150</sup>. Ashtu siç ilustron nga këta shembuj, iniciativa të tilla promovuese për promovimin dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore të

paluajtshme materiale të komuniteteve joshqiptare iniciohen rrallëherë nga institucionet e Kosovës dhe janë udhëhequr kryesisht nga organizatat ndërkombëtare si Këshilli i Evropës, OSBE dhe Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë.

Megjithatë, kohës së fundit është identifikuar një projekt në të cilin është përfshirë drejtpërdrejtë një institucion i Kosovës që ka marrë pjesë në financim bashkë me OJQ-në “Hanarin”. Më 6 nëntor 2013, është nënshkruar një memorandum mirëkuptimi për zbatimin e projektit “Promovimi i vlerave kulturore dhe identifikimi i trashëgimisë” ndërmjet MAPL-së dhe komunës së Hanit të Elezit. Sipas marrëveshjes, komuna e Hanit të Elezit ka pranuar €10,000 për të financuar një projekt që synon promovimin e vlerave kulturore dhe identifikimin e trashëgimisë kulturore në komunë<sup>151</sup>. Projekti përfshinte një fushatë kontaktimi<sup>152</sup> dhe lansimin<sup>153</sup> e një katalogu që përfshinte mbi 170 eksponate të llojeve të ndryshme, përfshi këtu disa objekte të trashëgimisë së paluajtshme.

Lidhur me këtë, vitet e kaluara është vërejtur mungesë e vetëdijesimit publik dhe angazhimit civil lidhur me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe vlerës së saj sociale e ekonomike. Më tej, kundërshtimi i fuqishëm në shpalljen e Ligjit për qendrën historike të Prizrenit dhe Ligjit për Fshatin Hoçë e Madhe është dëshmi e asaj që çështjet e trashëgimisë kulturore në Kosovë janë shumë të politizuara dhe se ende duhet të arrihet një kuptim i përbashkët për të mirat e trashëgimisë kulturore – pavarësisht nga origjina – për të gjitha komunitetet në Kosovë.

---

## 5. KONKLUZË

---

Korniza ligjore e Kosovës për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore është përgjithësisht në pajtim me standardet relevante ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Megjithatë, disa institucione përgjegjëse, siç është KTKK dhe grupi ndërmintor i punës për komunikim dhe implementim të ZVM-ve, në masë të madhe kanë mbetur joefektive. Më tej, në tërë tekstin e Ligjit për trashëgimi kulturore dhe aktet nënligjore përdoret termi “institucioni kompetent” në vend se të emërohet agjencia specifike, gjë që i lë të paqarta dhe të padefinuara përgjegjësitë e institucioneve të ndryshme. Hapësira për interpretime të ndryshme që rezultojnë nga kjo është problem i veçantë në fushën e inspektimit, meqë është e paqartë nëse inspektimi është përgjegjësi e institucioneve qendrore ose komunale. Ndonëse ka shumë hisedarë në fushën e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, mungon një mekanizëm i qartë bashkërendues dhe shkëmbimi i informacioneve ndërmjet institucioneve relevante bëhet vetëm sipas rasteve. Pavarësisht nga natyra tej-sektoriale e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve lokale dhe qendrore dhe ndërmjet departamenteve të ndryshme komunale dhe ministrive të ndryshme të linjës mbetet i kufizuar. Kapacitetet e kufizuara të punonjësve dhe mungesa e përkushtimit politik e ka vështirësuar edhe më shumë zbatimin e kornizës ligjore për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

MKRS ende nuk ka përmbledhur një inventar gjithëpërfshirës të aseteve të trashëgimisë kulturore të paluajtshme materiale në Kosovë dhe një listë të aseteve të trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përhershme. Në mungesë të një procesi të tillë të inventarizimit, vendet e trashëgimisë kulturore që nuk janë pjesë e ZVM-ve janë veçanërisht të cenueshme ndaj rrënimëve, akteve vandale, vjedhjeve dhe aktiviteteve të tjera shkatërruese. Kjo prek në veçanti trashëgiminë kulturore të komuniteteve jo-shqiptare.

Përveç rasteve të vjedhjes dhe vandalizmit, trashëgimia kulturore në Kosovë – veçanërisht e Kishës Ortodokse Serbe – rrezikohet nga vendime të disa komunave që cenojnë të drejtat pronësore apo që minojnë mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

Më tej, integrimi i vendeve të trashëgimisë kulturore në planet hapësinore lokale mbetet brengë. Jo të gjitha komunat kanë miratuar plane hapësinore komunale, që janë jetike për rregullimin e ndërtimit dhe zhvillimit përreth ZMV-ve dhe vendeve të tjera të trashëgimisë kulturore. Punimet ndërtimore në brendësi dhe pranë ZMV-ve vazhdojnë të ndodhin. Ndërtimet pa kontroll shumë afër vendeve të tjera të trashëgimisë kulturore dhe fetare mund të shihen rregullisht gjithashtu dhe, për mungesë të inspektorëve dhe burimeve të pamjaftueshme komunale, mund të mos trajtohen ashtu siç duhet. Iniciativat e institucioneve për të promovuar ruajtjen e trashëgimisë kulturore të paluajtshme materiale, veçanërisht atë të komunitetit joshqiptar, janë të pakta. Mungon vetëdijesimi i përgjithshëm për të mirat që sjell trashëgimia kulturore – pavarësisht nga origjina – për të gjitha komunitet në Kosovë.

Me tërë këto sfida të mbetura, efikasiteti i institucioneve të nivelit lokal në zbatimin e standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut lidhur me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore mbetet i kufizuar. Mbetet të shihet se çfarë ndryshimesh do të sjellë Ligji i ndryshuar për trashëgiminë kulturore dhe se si këto bashkë me themelimin rishtazi të divizionit për menaxhimin e integruar të trashëgimisë kulturore brenda MKRS-së do të kontribuojë në balancimin e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore dhe fetare me të drejtat e individëve dhe të komuniteteve që jetojnë përreth vendeve të trashëgimisë dhe në rritjen e qasjes dhe përfitimeve të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore për të gjitha komunitetet në Kosovë.



---

# 6. REKOMANDIME

---

## Për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve:

- Të përpilojë një inventar gjithëpërfshirës të aseteve të trashëgimisë kulturore të paluajtshme materiale në Kosovë dhe një listë të aseteve të trashëgimisë së paluajtshme kulturore në mbrojtje të përhershme, sipas nenit 4 të Ligjit për trashëgiminë kulturore.
- Të sigurojë trajnime profesionale për inspektorët komunalë për trashëgiminë kulturore dhe inspektorët e QRTK-ve për mbrojtjen e vendeve të trashëgimisë kulturore. Të sigurojë trajnim të avancuar për njësinë e themeluar kohëve të fundit të Policisë së Kosovës për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, veçanërisht pasi të jetë bërë i zbatueshëm Ligji i ri për trashëgiminë kulturore.
- T'i këshillojë komunitat, përfshirë edhe përmes deklaratave publike, që incidentet e sigurisë në vendet e trashëgimisë kulturore, do të dënohen publikisht.
- T'i dënojë publikisht rastet ku është cenuar trashëgimia kulturore përmes ndërtimeve të paligjshme.
- Të propozojë ndryshime në ligjin për trashëgiminë kulturore për të siguruar një mbikëqyrje më të mirë ndaj veprimeve të nivelit lokal për të mbrojtur dhe promovuar trashëgiminë kulturore, përkufizim më të qartë të roleve dhe ndarjes së detyrave ndërmjet institucioneve të nivelit qendror dhe lokal, bashkëpunim dhe bashkërendim ndërmjësor në çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe përkufizim më të qartë të obligimeve inspektuese të trashëgimisë kulturore për inspektorët komunalë dhe inspektorët e MKRS-së.
- Të bashkërendojë shkëmbim të rregullt të informatave (projekteve, çështjeve të sigurisë) ndërmjet institucioneve të nivelit qendror të përfshira në zbatimin e legjislacionit të trashëgimisë kulturore, duke përfshirë aktivitetet e rindërtimit në vendet e trashëgimisë kulturore në Kosovë dhe departamentet komunale.

## Për Kuvendin e Kosovës:

- Të sigurojë që KTKK të jetë plotësisht funksional dhe me numër të plotë të punonjësve, duke përfshirë përfaqësimin e komuniteteve joshqiptare në këtë organ.

## Për Policinë e Kosovës:

- Të vazhdojë me mbrojtjen e aktiviteteve në vendet e trashëgimisë kulturore përmes patrullimeve të rregullta dhe zbatimit të urdhrimit operacional.
- Të reagojë në incidentet e sigurisë me patrullime të shtuara.
- Të sigurojë patrullime të rregullta në vendet e trashëgimisë kulturore që nuk janë të Kishës Ortodokse e Serbe e që preken nga incidente të sigurisë.
- Të forcojë bashkërendimin dhe bashkëpunimin me KKS-së, KLSP-të dhe përfaqësuesit e komunitetit me qëllim të sigurimit dhe qetësimin të komuniteteve të prekura.

## Për komunitat:

- T'i dënojnë të gjitha incidentet e sigurisë që prekin vendet e trashëgimisë kulturore, në veçanti të komuniteteve joshqiptare, dhe të ndërmarrin me kohë aktivitetet e kontaktimit me qëllim që të sigurojnë dhe qetësojnë komunitetet e prekura.
- Të përkrahin Policinë e Kosovës përmes forumeve të rregullta siç janë Këshillat Komunalë për Siguri në Bashkësi, në përpjekjet e saj për të reaguar në mënyrë efektive dhe proaktive ndaj incidenteve të sigurisë ku përfshihen vendet e trashëgimisë kulturore.
- Të dëshmojnë përkushtim për t'i respektuar/zbatuar mekanizmat për mbrojtjen e vendeve të trashëgimisë kulturore të parapara me ligjet dhe rregulloret përkatëse.
- Të sigurojnë pjesëmarrje të Kishës Ortodokse Serbe në faza të hershme të ndërtimit nga komunitat që përfshijnë aktivitetet e kufizuara brenda ZVM-ve,

në mënyrë që të kërkohet pëlqimi i saj për ndërtimin/zhvillimin e propozuar sipas nenit 6 të Ligjit për zonat e veçanta të mbrojtura.

T'i finalizojnë dokumentet të planifikimit hapësinor ashtu siç kërkohet me Ligjin për planifikim hapësinor<sup>154</sup>, në mënyrë që të sigurojnë implementim të duhur të Ligjit për zonat e veçanta të mbrojtura dhe Ligjit për trashëgiminë kulturore që rezulton në mbrojtje legjitime të vendeve të trashëgimisë kulturore<sup>155</sup>.

Të realizojnë një plan për të siguruar inspektime të rregullta të vendeve të trashëgimisë kulturore nga inspektorët komunalë ashtu që të sigurohet përputhshmëri me obligimin për t'i raportuar nivelit qendror për çfarëdo ndërtimesh të vërejtura në vendet e trashëgimisë kulturore, për të siguruar përgjigje më të shpejtë në kërkesat e qytetarëve për lëshimin e lejeve të ndërtimit brenda ZVM-ve, për të shmangur mosmarrëveshje të tjera lidhur me ndërtimet e paligjshme dhe për t'i minimizuar dëmet në vendet e trashëgimisë kulturore (duke i rritur gjasat që dëmet e identifikuar në fazë të hershme të zhbëhen).<sup>156</sup>

## Për qendrat rajonale për trashëgimi kulturore:

Të realizojë një plan për të siguruar që inspektimet e rregullta në vendet e trashëgimisë kulturore bëhen në përputhje me Rregulloren e MKRS-së për autorizimet dhe kompetencat e inspeksionit për trashëgimi kulturore<sup>157</sup>.

## Referencat

1. Shih nenin 1, Konventa e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë (UNESCO) për mbrojtjen e trashëgimisë botërore kulturore dhe natyrore, 16 nëntor 1972. Trashëgimia materiale mund të ndahet më tutje në trashëgimi të luajtshme dhe të paluajtshme.
2. Shih nenin 2, Konventa e UNESCO për ruajtjen e trashëgimisë jomateriale kulturore, 17 tetor 2003.
3. UNESCO e përkufizon "trashëgiminë natyrore" si "tiparet natyrore që përbëhen nga formacione fizike dhe biologjike ose grupeve të formacioneve të tilla, të cilat janë me vlerë të jashtëzakonshme universale nga pikëpamja estetike ose shkencore; formacionet gjeologjike dhe fiziografike dhe zonat e përvijuara saktë që përbëjnë habitat për specie të rrezikuara të kafshëve dhe bimëve me vlerë të jashtëzakonshme universale nga pikëpamja e shkencës ose konservimit; apo vendet natyrore ose zonat natyrore të përvijuara saktë me vlerë të jashtëzakonshme universale nga pikëpamja e shkencës, ruajtjes ose bukurisë natyrore." Shih nenin 2, UNESCO, shënimi 1, më sipër.
4. Shih nenin 1, Konventa evropiane për peizazhin, ETS Nr. 176, Firencë, 20 tetor 2000.
5. Raport i Raportuesit të Posaçëm në fushën e të drejtave kulturore, Farida Shaheed, për Këshillin për të Drejtat e Njeriut, UN Doc. A/HRC/17/38, 21 mars 2011, f. 4.
6. Shih nenin 27, Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut (DUDNJ), Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara 217 A (III),

10 dhjetor 1948. Shoje edhe nenin 15, Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (PNDESK), Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara 2200A (XXI), 16 dhjetor 1966, hyri në fuqi më 3 janar 1976.

7. Shih nenin 27, Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (PNDKP), Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara 2200A (XXI), 16 dhjetor 1966, hyri në fuqi më 23 mars 1976.

8. Shih paragrafi 48, Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (KDESK), Komenti i përgjithshëm nr. 21: E drejta e të gjithëve për të marrë pjesë në jetën kulturore, UN Doc. E/C.12/GC/21, 21 dhjetor 2009.

9. M. Sepúlveda, Natyra e obligimeve në kuadër të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (Oksford: Intersentia, 2003), f. 157–208.

10. Të drejtat në kuadër të PNDESK japin më shumë thellësi të po këtyre të drejtave të përcaktuara në UDHR, duke përfshirë përmes komenteve të gjera dhe autoritative të organeve të ekspertëve të OKB-së në KDESK, që mbikëqyr zbatimin e PNDESK. (Shih në veçanti Komentin e përgjithshëm KDESK Nr. 21, shënimi 8, më sipër.) KDESK më parë ka nxjerrë observime përmbyllëse për nivelin e zbatimit të të drejtave të përcaktuara në PNDESK në Kosovë, dhe fushat prioritare për masat e ardhshme për respektimin, mbrojtjen dhe përmbylljen e këtyre të drejtave; shih Observimet Përmbyllëse të KDESK, për Dokumentin e dorëzuar nga UNMIK, UN Doc. E/C.12/UNK/CO/1 (1 dhjetor 2008).

11. Shih nenin 5, Konventa Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, ETS Nr. 157, 1 shkurt 1995.

12. Shih nenet 18, 19 dhe 26, UDHR, shënimi 6, më sipër.

13. Për shembull përmes Konventës së UNESCO për Diversitetin Kulturor, 2 nëntor 2001.

14. Roli i bashkësive dhe përfshirja e tyre në emërimin, menaxhimin dhe monitorimin e trashëgimisë kulturore është rritur gjatë viteve nga Konventa e UNESCO-s në lidhje me Mbrojtjen e Trashëgimisë Botërore Kulturore dhe Natyrore, shënimi 1, sipër. Në vitin 2007, Komiteti i Trashëgimisë Botërore prezantoi një objektiv strategjik shtesë, duke i bërë thirrje shteteve për të rritur rolin e komuniteteve në zbatimin e Konventës. Gjithashtu shih paragrafët 39 dhe 40 të Udhëzimeve Operacionale Komitetit të Trashëgimisë Botërore për Zbatimin e Konventës së Trashëgimisë Botërore, 08/01, janar 2008. Gjithashtu, seancën e 32-të, në kohën e miratimit të Konventës për Ruajtjen e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale, shënimi 1 sipër, UNESCO në mënyrë specifike ka përkrahur rolin e komuniteteve karshi trashëgimisë kulturore jomateriale, duke pranuar që: "komunitetet, në veçanti komunitetet indigjene, grupet dhe në disa raste edhe individët luajnë një rol të rëndësishëm në prodhimin, ruajtjen, mbajtjen dhe rikrijimin e trashëgimisë kulturore jomateriale". Për më tepër, shih paragrafët 14, 15 dhe 65, të Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare të Komitetit Këshillues. Komentet për pjesëmarrjen efektive të personave që i përkasin pakicave kombëtare në jetën kulturore, sociale dhe ekonomike dhe në çështjet publike. Miratuar më 27 shkurt 2008. ACFC/31/DOC(2008)001, Strasburg, 5 maj 2008. Në paragrafin 65 Komiteti Këshillues shtjellon që nenet 5, 6 dhe 15 të Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare "mbrojnë edhe të drejtën e personave që i përkasin pakicave për ruajtjen dhe zhvillimin e trashëgimisë së tyre kulturore edhe identitetin dhe të drejtën e tyre për të marrë pjesë në mënyrë efektive dhe bashkëpunuar në jetën e rregullt kulturore, në frymë të tolerancës dhe dialogut ndërkulturor."

15. Shih preambulën e Konventës Kornizë në Vlerën e Trashëgimisë Kulturore për Shoqërinë. ETS Nr. 199, Faro, 27 tetor 2005.

16. Shih nenet 4, 12 dhe 14, po aty.

17. Shih në veçanti Kartën e UNESCO për ruajtjen e trashëgimisë digjitale, 15 tetor 2003.

18. Raport i Raportuesit të Posaçëm në fushën e të drejtave kulturore, Farida Shaheed, për Këshillin për të Drejtat e Njeriut, shënimi 5, sipër, f. 16.

19. Shih nenin 2, PNDKP, fusnota 7, më sipër; Neni 8, DUDNJ, fusnota 6, më sipër; paragrafi 72, PNDESK, Komenti i Përgjithshëm nr. 21, fusnota 8, më sipër; Shih gjithashtu neni 11, Deklarata e Friburgut mbi të Drejtat Kulturore, 7 maj 2007.

20. Parimet themelore dhe Udhëzimet e OKB-së për të drejtën në mjete juridike dhe reparacion për viktimat e shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut dhe shkeljeve të rënda të të drejtës ndërkombëtare humanitare, Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara 60/147,

16 dhjetor 2005.

21. Ligji nr. 03/L-039 për Zonat e Veçanta të Mbrojtjes, 15 qershor 2008.

22. Ligji nr. 02/L-88 për Trashëgiminë Kulturore, 6 nëntor 2006 (Ligji për Trashëgiminë Kulturore).

23. Rregullorja e MKRS-së nr. 01-2008 për Procedurat e Gjurmimit-Hetimit; Rregullorja e MKRS-së nr. 02-2008 për Qasjen Publike në Trashëgiminë Kulturore në Pronësi private; Rregullorja e MKRS-së nr. 03-2008 për Aktivitetet e konservimit dhe restaurimit të trashëgimisë kulturore; Rregullorja e MKRS-së nr. 04-2008 për Autorizimet dhe Kompetencat e Inspeksionit të Trashëgimisë Kulturore; Rregullorja e MKRS-së nr. 05-2008 për Regjistrimin, Dokumentimin, Vlerësimin dhe Përzgjedhjen e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje; Rregullorja e MKRS-së nr. 06-2008 për Masat e Sigurisë për Trashëgimi të Luajtshme; Rregullorja e MKRS-së nr. 07-2008 për Procedurat e Licencimit për Tregtarë të Trashëgimisë së Luajtshme.

24. Ligji nr. 04/L-066 për Qendrën Historike të Prizrenit, 9 korrik 2012.

25. Ligji nr. 04/L-062 për Fshatin Hoçë e Madhe, 9 korrik 2012. Miratimi i Ligjit është politizuar tej mase nga Kryetari i Komunës si dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile në lidhje me rolin e Kishës Ortodokse Serbe, si anëtare e këshillit të fshatit në hartimin e politikave në planifikimin hapësinor dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në Hoçë e Madhe. Hoça e Madhe është vendbanim, kryesisht i banuar nga serbët, në Komunën e Rahovecit (me shumicë shqiptare). Miratimi i një ligji specifik për t'i dhënë fshatit statusin e një ZMV-je parashihet me Ligjin për Zonat e Mbrojtjes së Veçantë, fusnota 21, më sipër.

26. Miratimi i këtyre dy ligjeve është politizuar tej mase, si dhe është përballur me kundërshtime të fuqishme nga përfaqësuesit komunalë dhe disa organizata të shoqërisë civile në komunën e Prizrenit dhe atë të Rahovecit.

27. Projekt-Udhëzimi Administrativ për themelimin, përzgjedhjen, përgjegjësitë dhe funksionimin e Këshillit për Trashëgimi Kulturore; si dhe Projekt-Udhëzimi Administrativ për themelimin, përzgjedhjen, përgjegjësitë dhe funksionimin e Këshillit për Fshatin Hoçë e Madhe.

28. Shin Planin Vjetor të Punës së Qeverisë për vitin 2012, në dispozicion në faqen e Zyrës së Kryeministrit:

[http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Plani\\_i\\_dokumenteve\\_Strategjike\\_2012.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Plani_i_dokumenteve_Strategjike_2012.pdf) (qasur më 26 Mars 2014).

29. Drejtori i Departamentit të MKRS-së për Trashëgimi Kulturore, intervistë, 14 tetor 2013. Grupi punues përbëhet nga përfaqësuesit e institucioneve të ndryshme të Kosovës (përfshirë këtu edhe MKRS-në), zyrtarët komunalë, si dhe përfaqësues nga administrata tatimore.

30. Ligji i ndryshuar për Trashëgiminë Kulturore pritet të shpallet më 2014.

31. Takimet e grupit punues për projektligjin për trashëgimi kulturore, 16-22 tetor 2013.

32. Shih neni 22, Ligji nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, 15 qershor 2008.

33. Shih nenet 2, 5 dhe 7, Ligji nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Kosovë, 15 qershor 2008.

34. Shih Ligji nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor, 7 shtator 2013. Ky ligj shfuqizon Ligjin nr. 2003/14 për Planifikimin Hapësinor, të datës 10 shtator 2003, si dhe Ligjin nr. 03/L-106 për ndryshim/plotësimin e Ligjit për Planifikimin Hapësinor nr. 2003/14, 17 nëntor 2008. Megjithatë, këto ligje ende kanë rëndësi për këtë raport, pasi që ende përbëjnë ligjin në fuqi për shumicën e shembujve të marrë në këtë Raport.

35. Shih nenet 5, 21 dhe 25, Ligji nr. 04/L-110 për Ndërtim, 19 qershor 2012.

36. KKTK është themeluar më 2010, neni 4.8 i Ligjit për Trashëgimi Kulturore, fusnota 22, më sipër.

37. Shih nenet 4.3 dhe 4.4, Ligji për Trashëgimi Kulturore, fusnota 22, më sipër.

38. Shih nenin 4.9, po aty.

39. Shih nenin 5.2, po aty. Neni 4.3 gjithashtu parasheh që KKTK ka për detyrë të shqyrtojë, miratojë apo hedhë poshtë propozimet në lidhje me objektet e trashëgimisë kulturore të propozuara për mbrojtje të përhershme.

40. Shih faqen e KKTK-së, <http://mem.rks-gov.net/?cid=2,1> (qasur më 26 Mars 2014).

41. Neni 4.8, Ligji për Trashëgimi Kulturore, fusnota 22, më sipër, përcakton që Këshilli përbëhet nga shtatë anëtarë të emëruar për një mandat trevjeçar

nga Kuvendi i Kosovës, duke respektuar përbërjen etnike të Kosovës.

42. Neni 14, fusnota 24, më sipër.

43. Shih Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë / Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian në Kosovë, "Qendra e Parë Rajonale e Trashëgimisë Kulturore në Ballkan hapet në Prizren" "[http://www.eeas.europa.eu/delegations/kosovo/press\\_corner/all\\_news/news/2011/20110916\\_en.htm](http://www.eeas.europa.eu/delegations/kosovo/press_corner/all_news/news/2011/20110916_en.htm) (qasur më 26 Mars 2014).

44. Në bazë të nenit 4, Ligji për Fshatin Hoçë e Madhe, fusnota 25, më sipër.

45. Drejtori i Departamentit të MKRS-së për Trashëgimi Kulturore, intervistë me personin, 18 dhjetor 2013. Edhe pse grupi punues është takuar rregullisht, arritja e tij më kuptimplotë ka qenë një fushatë vetëdijësuese në gjithë Kosovën, duke përfshirë botimin e një broshure për Zonat Mbrojtëse dhe ZMV-të. Kapacitetet e kufizuara të personelit, si dhe mungesa e përkushtimit politik, janë përmendur si pengesat kryesore ndaj përparimit në kryerjen e detyrave të tjera.

46. Shih nenin 4, Ligji për Zonat e Veçanta të Mbrojtjes, fusnota 21, më sipër.

47. Anëtarë të KIM-së kanë qenë: MKRS, IKMM, Instituti në Leposaviq për Mbrojtjen e Monumenteve, Kisha Ortodokse Serbe, Këshilli i Evropës, UNESCO dhe OSBE.

48. Udhëzimi Administrativ i MMPH-së nr. 03/2013 për Këshillin për Implementim dhe Monitorim, 12 shkurt 2013.

49. Shih nenin 2, po aty.

50. Bashkë-kryesuesi i KIM-së (ambasadori grek në Kosovë) është edhe Lehtësuesi i BE-së për çështje në lidhje me mbrojtjen e trashëgimisë fetare dhe kulturore të Kishës Ortodokse Serbe.

51. Shih fusnotën 104, infra.

52. Shih Raportin e Këshillit të Evropës "Komiteti Këshillues për Konventën Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare" f. 22-23. Gjetet tek: [http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/minorities/3\\_FCNMdocs/PDF\\_3rd\\_OP\\_Kosovo\\_en.pdf](http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/minorities/3_FCNMdocs/PDF_3rd_OP_Kosovo_en.pdf).

53. Në rast të incidenteve të sigurisë në objekte të trashëgimisë kulturore (shih Kapitullin 4.1 për më shumë informata të hollësishme).

54. Ata kanë fokus të veçantë tek planifikimi hapësinor dhe ZMV-të.

55. Përveç drejtorive komunale për kulturë, edhe drejtoritë tjera, si ajo e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, kontribuojnë në mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore.

56. Kreu i Divizionit të Trashëgimisë Kulturore, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Punëtorja e OSBE-së për "Legjislacionin e trashëgimisë kulturore: Zbatimi dhe sfida", Pejë, 19 qershor 2012.

57. Shih kapitujt 3-5 si më poshtë.

58. Shih Programin e përbashkët Bashkim Evropian/Këshill i Evropës për Përkrahjen në promovimin e diversitetit kulturor në Kosovë, Udhëzuesi për inventarizimin e pasurive të trashëgimisë kulturore, shkurt 2011, f.9.

59. Po aty, f.9.

60. Neni 3, Ligji për Trashëgiminë Kulturore, fusnota 22, më sipër.

61. Neni 4, po aty. Drejtori i Departamentit të MKRS-së për Trashëgimi Kulturore ka theksuar që MKRS-ja është e gatshme të veprojë në përputhje me Ligjin për Trashëgimisë Kulturore, pasi KKTK të bëhet funksionale (korrespondencë me shkrim, 17 shkurt 2014).

62. Neni 4.4, po aty.

63. Këto dy çështje janë përmendur nga drejtorët e IRMM-ve gjatë tryezave të rumbullakëta të sponsorizuara nga OSBE-ja për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, qershor 2012.

64. Drejtori i Departamentit të MKRS-së për Trashëgimi Kulturore, korrespondencë me shkrim, 17 shkurt 2014.

65. Po aty.

66. Neni 3.6, Ligji për trashëgiminë kulturore, shënimi 22, më lart.

67. Ligji për zonat e veçanta të mbrojtura, shënimi 21, më lart.

68. Shih nenin 2, po aty.

69. Shih nenin 3, po aty.

70. Shih nenin 12, MMPH Udhëzimi administrativ për Këshillin Zbatues Monitorues, shënimi 47, më sipër.

71. MMPH Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020, qershor 2010.

72. Teqeja është njëkohësisht edhe kube varrimi edhe shtëpi e lutjes për myslimanet sufistë sheitë (dervishët). Teqeja e mbanë arkivoliin e shehut, apo prijësve fetar, zakonisht të themeluesit të teqesë.

73. Komuna e Pejës e ka hartuar PZHK-në në bashkëpunim me institutin rajonal për mbrojtjen e monumenteve. Si PZHK-ja ashtu edhe PZHU-ja



janë miratuar nga MMPH-ja në fillim të vitit 2007.

74. Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për planifikimin hapësinor, shënimi 34 më sipër.

75. Vendimi i KK-së është marrë më 3 mars 2011. Vlen të theksohet që propozimi për përfshirjen e Patriarkanës së Pejës si ZVM në planet hapësinore komunale është miratuar me 22 vota nga 37 anëtarë të KK-së sa ishin të pranishëm në seancë.

76. Këtu përfshihen Deçani, Gjakova, Istogu, Juniku, Mitrovica/Mitrovica, Obiliqi, Peja, Prizreni dhe Vushtrria.

77. Një numër i objekteve të trashëgimisë kulturore gjenden në atë zonë, përfshirë Xhaminë Fatih, Hamamin e Madh, Parkun Etnologjik, Sahatkullën dhe Xhaminë Bazar. Drejtoria komunale e urbanizmit e ka hartuar një projekt në kuadër të PRRU-së i cili përfshinë restaurimin, ruajtjen dhe përfshirjen e zonës historike dhe i cili është shqyrtuar nga MKRS-ja. Këtë informatë OSBE-ja e ka siguruar nga një zyrtar nga departamenti i urbanizmit në komunën e Prishtinës, gjatë një interviste me personin më 22 tetor 2013.

78. Zyrtari nga departamenti i urbanizmit në komunën e Prishtinës, intervistë me personin më 22 tetor 2013.

79. Shih nenin 5, Ligji për zonat e veçanta të mbrojtura, shënimi 21, më sipër.

80. Plani Hapësinor i Kosovës i MMPH-së për periudhën 2012–2020, shënimi 71, më sipër, f. 179–180.

81. Po aty, f. 130.

82. Kjo iu është raportuar OSBE-së nga drejtori i urbanizmit, në komunën e Lipjanit më 4 shtator 2013. Që nga janari i vitit 2013, OSBE-ja ka avokuar vazhdimisht për integrimin e ZMV-së në planet hapësinore komunale. Procesi i rishikimit dhe ndryshimit të plotësimit të PZHK-së dhe PZHU-së në komunën e Lipjanit ka përfunduar më 24 korrik 2013 me miratimin përfundimtar nga Kuvendi Komunal.

83. Po aty.

84. Më 21 maj 2013, drejtori i urbanizmit në komunën e Lipjanit ishte takuar me priftin lokal të Kishës Ortodokse Serbe të Shpalljes së Virgjëreshës në ndërtesën e komunës. Takimi ishte lehtësuar nga OSBE-ja, pas diskutimeve të mëparshme ndërmjet drejtorit dhe OSBE-së përkitazi me procesin e rishikimit dhe ndryshimit të plotësimit të PZHK-së dhe PZHU-së.

85. Shih shënimin 104, infra, përkitazi me përfshirjen e KZM-së në këtë çështje.

86. Shih nenin 33.3 të Ligjit për ndërtim, shënimi 35 më sipër. Inspektorët komunal të ndërtimit gjithashtu lejohen që ta urdhërojnë poseduesin që ta "ta rënojë objektin ndërtimor nëse është vërtetuar se ka parregullsi të pariparueshme që rezikojnë stabilitetin e ndërtimit, stabilitetin e ndërtimeve fqinje apo vë në rezik jetën e personave" (neni 34). Përveç kësaj komunat do të vlerësojnë resurset dhe kapacitetet e tyre të brendshme për lëshimin e lejeve ndërtimore dhe propozojnë taksat e lejeve ndërtimore (neni 38.5).

87. Neni 38.4, i Ligjit për ndërtim, shënimi 35, më sipër, parasheh që Ministria, obligohet që të nxjerr udhëzimet e domosdoshme administrative për zbatimin e këtij ligji dhe që ato përfshijnë standardet dhe procedurat minimale për mbikëqyrjen inspektuese të punëve ndërtimore brenda kompetencave të këtij ligji.

88. Shih Rregulloren e MKRS-së Nr. 04/2008 për autorizimet dhe kompetencat e inspektimeve për trashëgiminë kulturore, shënimi 23, më sipër, e cila parasheh inspektime që kryhen nga MKRS-ja.

89. Drejtori i MKRS-së, departamenti për trashëgimi kulturore, intervista verbale më 20 maj 2013.

90. Lista e re e vendeve të trashëgimisë kulturore përmban 45 pasuri arkeologjike të trashëgimisë kulturore, 77 pasuri arkitektuale të trashëgimisë kulturore dhe për herë të parë, 200 pasuri të luajtshme të trashëgimisë kulturore. Shih MKRS, "Është nënshkruar lista e përkohshme e monumenteve të trashëgimisë kulturore të mbrojtura", <http://www.mkrs-ks.org/?page=2,6,655> (e qasur më 26 Mars 2014). Lista e mëparshme e pasurive të trashëgimisë kulturore të mbrojtura është nënshkruar nga ministri për kulturë rini dhe sport më 1 tetor 2012 dhe i ka përmbajtur 1,181 pasuri të trashëgimisë kulturore dhe ka qenë e zbatueshme për një vit kalendarik.

91. Neni 11.2, Ligji për trashëgiminë kulturore, shënimi 22, më sipër.

92. Po aty.

93. OSBE-ja është informuar që, derisa nuk bëhen inspektime të rregullta, QRTK-të – sipas udhëzimeve të MKRS-së – rregullisht i monitorojnë projekt-aktivitetet në lidhje me vendet e trashëgimisë kulturore dhe i raportojnë ato te komunat relevante, p.sh. inspektoratet komunale dhe

drejtoritë e urbanizmit. Burimi: Drejtori i MKRS-së departamenti për trashëgimi kulturore, korrespondenca me shkrim e datës 17 shkurt 2014.

94. Kisha e Shën Kyriake (e njohur te serbët e Kosovës si Kisha e Shenjtë e të Dielës) është ndërtuar në shekullin XIV dhe është restauruar tërësisht në vitet e 1960-ta. Brendësia e saj, përfshirë pikurat e murit janë dëmtuar nga zjarri gjatë trazirave të marsit të vitit 2004 në Kosovë. Kisha ruhet pandërprerë nga Policia e Kosovës.

95. Drejtori i urbanizmit dhe planifikimit hapësinor, komuna e Prizrenit, intervistë me personin, tetor 2013.

96. Drejtori i urbanizmit, intervistë telefonike, 29 korrik 2013.

97. Më 25 dhe 26 korrik, drejtori i inspeksionit e ka vizituar vendin dhe ka folur me pronarin i cili i kishte treguar që nuk e kishte pasur për qëllim që të ndërtojë asnjë ndërtesë tjetër. Drejtori i inspeksionit, intervistë telefonike, 29 korrik 2013.

98. Ky aktivitet i ndërtimit brenda ZMV-së së Manastirit të Deçanit është diskutuar në takimin e 6 KZM-së më datën 10 shtator 2013. Ministri për mjedis dhe planifikim hapësinor ka theksuar që ai do të takohet me kryetarin e komunës së Deçanit drejtpërdrejt pas takimit të KZM-së dhe që do ta ngritë çështjen e aktiviteteve të reja ndërtimore që ishte ngritur më parë nga Kisha Ortodokse Serbe.

99. Këto janë kryesisht ndërtime të shtëpive private që ose janë pa leje ose i tejkalojnë parametrat e përcaktuar në leje.

100. Drejtori i RIPM, rajoni i Prizrenit, intervista me personin, tetor 2013.

101. Kisha e Shpalljes së Virgjëreshës është në listën e vendeve të përkufizuara si ZVM sipas nenit 7 të Ligjit për zonat e veçanta të mbrojtura, shënimi i 21-të më sipër.

102. Pronari i pronës në fjalë kishte marrë nga komuna pëlqimin për plotësimin e kushteve teknike për ndërtimin e një strukture të vogël të përkohshme që do të shërbente si hapësirë për punë administrative të kompanisë. Komuna e njoftoi Kishën Ortodokse Serbe për kërkesën, me ç' rast kjo e fundit shprehu mospajtim me kryerjen e punëve të ndërtimit brenda ZMV-së. Më pas, çështja iu përcoll për shqyrtim KZM-së.

103. Rekomandim i drejtorit të Inspektoratit të MMPH-së i datës 15 gusht 2013.

104. Shkatërrimi i depos së ndërtuar në mënyrë të paligjshme u raportuar në takimin e 6-të të KZM-së më 10 shtator 2013.

105. Drejtori i urbanizmit, intervistë përmes telefonit, 29 korrik 2013.

106. Siç u raportua gjatë takimit të 6-të të KZM-së më 10 shtator 2013.

107. Siç rrjedh nga neni 15 i PNDESK-ut, shënimi i 6 më sipër.

108. Sipas statistikave të Policisë së Kosovës dhe monitorimit në terren të OSBE-së.

109. Shih nenin 7, Ligji për zonat e veçanta të mbrojtura, shënimi i 21-të më sipër.

110. Monumenti i Gazimestanit më 18 mars 2010, Manastiri i Graçanicës më 23 gusht 2010, Manastiri i Sokolicës më 25 shtator 2010, Manastiri i Zoqishtës (Shën Damjanit dhe Kuzmës) më 3 nëntor 2010, Manastiri i Budisavcit më 22 nëntor 2010, Manastiri i Goriçit më 15 dhjetor 2010; dhe Manastiri i Arkangjelit të Shenjtë më 10 maj 2011.

111. Manastiri i Deviçit në komunën e Skenderajt.

112. Manastiri i Deçanit në komunën e Deçanit.

113. Pas një vlerësimi të rrezikut nga Policia e Kosovës në vitin 2013, kompleksi arkeologjik i Ulpijanës u hoq nga mbrojtja 24-orëshe nga Policia e Kosovës.

114. Gjithë vendet e tjera veç vendeve të trashëgimisë kulturore të Kishës Ortodokse Serbe dhe të serbëve të Kosovës janë quajtur vetëm si vende të trashëgimisë kulturore nëpër raportet e Policisë së Kosovës në mënyrë ad-hoc. Asnjë prej tyre nuk është vendosur nën mbrojtje të veçantë sipas urdhrit operativ.

115. Monitoruesit e OSBE-së në terren kanë identifikuar 58 incidente që i kanë prekur të gjitha vendet në të njëjtën periudhë.

116. Të dy incidentet që ngjanë në vende nën mbrojtje 24-orëshe ishin vjedhje. Më 13 prill 2011, u zbulua se çatisë së Kishës Ortodokse Serbe së Virgjëreshës së Shenjtë të Levishkës në Prizren po i mungonin diku rreth 14 m<sup>2</sup> së mbështjellësja nga plumbi. Policia e Kosovës në ndërkohë ka paraqitur si dëshmi fotografi që tregojnë se çatisë i mungonte mbështjellësja nga plumbi qysh në kohën kur përgjegjësia për sigurinë e këtij vendi i kaloi policisë. Më 15 maj, shtatorja e Car Dushanit u vodh nga Manastiri i Shën Arkangjelit në komunën e Prizrenit.

117. Ndryshe nga statistikave të Policisë së Kosovës, monitoruesit në terren të OSBE-së kanë identifikuar 71 incidente të cilat kanë prekur të gjitha

vendet në të njëjtën periudhë. Kjo mospërputhje mbas gjase rrjedh për shkak se kategorizimi i Policisë së Kosovës i asaj se çfarë përbën incidentet që prek vendet e trashëgimisë kulturore e çfarë jo dallon nga kategorizimi i OSBE-së. Gjithashtu, Policisë së Kosovës nuk i raportohen gjithë incidentet e sigurisë që prekin trashëgiminë kulturore.

118. Shih faqen e internetit të OSBE-së, "OSBE do ta trajtojë Policinë e Kosovës në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe fetare" <http://www.osce.org/kosovo/102830> (qasur më 26 Mars 2014).

119. KKSB-të janë organe komunale të detyrueshme të themeluara me Ligjin nr. 03/L-035 për Policinë, 4 qershor 2008. Sipas nenit 7(3), KKSB është "është një organ këshillues i kryesuar nga kryetari i komunës dhe anëtarë që janë përfaqësues të të gjitha komuniteteve përbrenda komunës"; Neni 7(4) specifikon se ai është i adresuar çështjet e sigurisë që i prekin komunitetet, KKSB-të duhet të themelohen në çdo komunë dhe duhet të sigurojnë përfaqësim të barabartë të të gjitha "komuniteteve etnike" që banojnë në atë komunë, si dhe të palëve të tjera të interesit. Shih nenet 1 dhe 3 të Udhëzimit administrative nr. 08/2009 të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB)- 02/2009 të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) për Këshillat Komunalë për Siguri në Bashkësi, 20 mars 2009.

120. Shih raportin e OSBE-së, "Reagimet komunale ndaj incidenteve të sigurisë që prekin komunitetet e Kosovës dhe roli i Këshillave Komunalë për Siguri në Bashkësi", dhjetor 2011. Në dispozicion në <http://ëëë.osce.org/kosovo/86766> (qasur më 26 Mars 2014). Si organe kryesore këshilluese i komunës për t'i adresuar çështjet e sigurisë që i prekin komunitetet, KKSB-të duhet të themelohen në çdo komunë dhe duhet të sigurojnë përfaqësim të barabartë të të gjitha "komuniteteve etnike" që banojnë në atë komunë, si dhe të palëve të tjera të interesit. Shih nenet 1 dhe 3 të Udhëzimit administrative nr. 08/2009 të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB)- 02/2009 të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) për Këshillat Komunalë për Siguri në Bashkësi, 20 mars 2009.

121. Zveçani, Leposaviqi, Mitrovica dhe Zubin Potoku.

122. OSBE, Komiteti Lokal për Siguri Publike, në dispozicion në <http://ëëë.osce.org/kosovo/74732> (qasur më 26 Mars 2014).

123. Gjithsej 38 KLSP janë themeluar në 17 komuna.

124. Janë raportuar dëmtime të më se 150 gurrë varresh ortodokse serbe, si dhe incidente të zjarrvënies dhe shkrimit të grafitëve që për shënjestër kanë pasur kishat ortodokse serbe. Incidentet kanë ngjarë në komunën e Fushë Kosovës, Kllokotit, fshatrat Plemetin dhe Milloshevë në komunën e Obiliqit, fshatin Prelluzhë në komunën e Vushtrisë, fshatin Syrganë në komunën e Skenderajt, si dhe në qendrën historike të Prizrenit. Gjithashtu, i është vënë zjarr kishëzës ortodokse serbe të varrezave të Milloshevës.

125. Komuna e Fushë Kosovës ka ndarë €20,000, gjersa €77,000 janë ndarë nga qeveria e Kosovës.

126. Drejtori i OJQ-së "Raskrshqë", intervistë me gojë, 26 korrik 2013. Afërsisht 50 gurrë varresh janë riparuar. OJQ-ja i ka ridestinuuar €30,000 të mbetura për pastrimin e varrezave të zgjedhura ortodokse serbe. Ekipe të OSBE-së në terren i kanë vizituar vendet në fjalë gjatë korrikut të vitit 2013 dhe kanë konfirmuar se punët e riparimit janë përfunduar në të pesë rajonet.

127. Shih raportin e OSBE-së, "Reagimet komunale ndaj incidenteve të sigurisë që prekin komunitetet e Kosovës dhe roli i Këshillave Komunalë për Siguri në Bashkësi" (2011) në: <http://www.osce.org/kosovo/86766> (qasur më 26 Mars 2014).

128. Manastiri i Shëruesve të Shenjtë Kuzma dhe Damjan në fshatin Zoqishtë është nën regjim të mbrojtjes së veçantë sipas Ligjit për zonat e veçanta të mbrojtura, shënimi i 21-të më sipër.

129. Kjo iu raportua OSBE-së nga ana e abatit të Manastirit të Zoqishtë më 7 qershor 2011.

130. Letra e komunës drejtuar autoriteteve kompetente të Kishës Ortodokse Serbe e datës 20 qershor 2011.

131. Letra e Peshkopit të Dioqezës së Rashkës së Prizrenit drejtuar komunës e datës 21 korrik 2011.

132. Letra e drejtorit komunal për kadastrë, gjeodezi dhe pronë drejtuar Peshkopit të Dioqezës së Rashkës së Prizrenit e datës 5 gusht 2011.

133. Vonesa ka ndodhur për shkak se komuna pohonte se nuk kishte fonde të mjaftueshme për ndërtimin e murit mbështetës. Intervista me drejtorin për planifikim urban. Komuna e Rahovecit, 5 shkurt 2013. Në maj të vitit 2013, komuna kërkoi fonde nga MMPH-ja. Intervista me drejtorin për planifikim urban, komuna e Rahovecit, 18 shtator 2013. Më 4 shtator 2013, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik i Kosovës shpalli tender për

ndërtimin e murit. KZM e vëzhgoi për së afërmi situatën dhe gjatë takimeve të KZM-së jepeshin rregullisht informatat e fundit.

134. Ligji për zonat e veçanta të mbrojtura, shënimi 21, sipër.

135. Shih neni 6(a), po aty, që përcakton se në aktivitetet e kufizuara që kërkojnë autorizimin nga Kisha Ortodokse Serbe përfshihet edhe ndërtimi i rrugëve.

136. Neni 3.3, Ligji Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e pronës së paluajtshme, 28 tetor 2010, thotë që "Objekt i shpronësimit sipas këtij ligji mund të jenë të drejtat private pronësore ose të drejtat tjera private në një pronë të paluajtshme, me përjashtim të të drejtave në pronën e paluajtshme të cilat janë pjesë e një kategorie të pronës e cila në bazë të Kushtetutës ose Propozimit Gjithëpërfshirës shprehimisht janë përcaktuar se nuk mund të jenë objekt i shpronësimit."

137. Kjo u arrit të futej vetëm në Ligjin Nr. 04/L-144 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, 22 nëntor 2011.

138. Shënimi 136, sipër.

139. Letër nga menaxheri i projektit në komunën e Pejës drejtuar Patriarkanës së Pejës e datës 16 maj 2011.

140. Neni 6(a), Ligji për zonat e veçanta të mbrojtura, shënimi 21, sipër, përcakton se në aktivitetet e kufizuara që kërkojnë autorizimin nga Kisha Ortodokse Serbe përfshihet edhe ndërtimi i rrugëve.

141. Letër nga Patriarkana e Pejës, datë 18 korrik 2011.

142. Letër nga menaxheri i projektit në komunën e Pejës për MKRS datë 15 gusht 2011.

143. Për shembull, OSBE-ja ka vërejtur se komunikimi ndërmjet kryesuesit të Kuvendit Komunal në Prizren dhe priftit ortodoks serb në krye të Katedrales Shën Gjergji në Prizren është përmirësuar, që shërben si mundësi që të dyja palët të ngrehin shqetësime lidhur me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në Prizren.

144. Shih neni 1.1, Ligji për trashëgiminë kulturore ku ceket se objekti i ligjit përfshin mjetet juridike dhe teknike, mese tjerash, për përhapje, shënimi 22, më sipër. Institucioni kompetent është përcaktuar në neni 2.19 si organi i caktuar me ligj për mbikëqyrjen e Përhapjes së Trashëgimisë Kulturore. Sipas nenit 2.13 të atij ligji, "përhapja" përfshin "veprimtari arsimore dhe rritëse të vetëdijesimit në lidhje me vlerat e trashëgimisë kulturore".

145. Ditëve të Trashëgimisë Evropiane, është një nismë e përbashkët e Këshillit të Evropës dhe Komisionit Evropian. Çdo vit në shtator organizohen ngjarje kombëtare dhe rajonale në tema të posaçme në tërë Evropën, duke nënvizuar shkathtësitë dhe traditat vendore, arkitekturën dhe punimet artistike, por synimi i përgjithshëm është që qytetarët të afrohen në harmoni, ndonëse ka dallime në kultura dhe gjuhë. Në Kosovë, MKRS merr pjesë bashkë me Këshillin e Evropës në organizimin e ngjarjeve. Për shembull, (në partneritet me Ambasadën Britanike në Prishtinë, Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë/Përfaqësuesi Special i BE-së dhe Këshilli i Evropës) OJQ-ja Promovimi i Menaxhimit të Trashëgimisë Perëndimi (PHM-West) organizoi Trenin e Trashëgimisë 2013 në dy fundjava në periudhën ndërmjet 14-29 shtator, që përfshinte udhëtimin nga Prishtina për në Pejë dhe Deçan si pjesë e festimit në Kosovë të Ditëve të Trashëgimisë Evropiane 2013. Programi i vizitave ka përfshirë një turne me udhërrëfyes në vendet kryesore të trashëgimisë në komunën e Pejës dhe Deçanit.

146. Neni 2.21, Ligji për trashëgiminë kulturore, shënimi 22, më sipër, përkufizon "Zonën e mbrojtur" si "hapësirë të vendit siç është përcaktuar në neni 2 të Ligjit nr. 2003/14 për planifikim (ligji nr. 2003/14) që rrethon perimetrin e trashëgimisë së paluajtshme të mbrojtur që mund të ruhet nga zhvillimet apo aktivitete që mund ta dëmtojnë konfiguracionin vizual apo shkaktojnë dëme tjera të trashëgimisë kulturore." Shih edhe neni 7, po aty. Përderisa "Zonat e veçanta të mbrojtura" përcaktohen me Ligjin për zonat e veçanta të mbrojtura, shënimi 21, më sipër, rreth 45 vende specifike të trashëgimisë kulturore me rëndësi të posaçme për komunitetin serb të Kosovës si dhe komunitetet tjera në Kosovë

147. Më 1 tetor 2012, organizata Trashëgimia Kulturore Pa Kufij lidhi një Memorandum të Mirëkuptimit për programin "Planet lokale të trashëgimisë kulturore 2012-2015" me MKRS, MMPH dhe dy komunat e Dragashit dhe Rahovecit në rajonin Prizrenit. Shih raportin e Këshillit të Evropës, "EU/CoE mbështet promovimin e diversitetit kulturor në Kosovë" [http://www.coe.int/t/dg4/cultureheritage/cooperation/Kosovo/default\\_en.asp](http://www.coe.int/t/dg4/cultureheritage/cooperation/Kosovo/default_en.asp) dhe Promovimi i menaxhimit të trashëgimisë - faqja e internetit e organizatës West (PHM), <http://www.phm-west.org/phm/index.html> (vizituar më 26

---

Mars 2014).

148. Shih raportin e Këshillit të Evropës, "EU/CoE mbështet promovimin e diversitetit kulturor në Kosovë" [http://www.coe.int/t/dg4/cultureheritage/cooperation/Kosovo/default\\_en.asp](http://www.coe.int/t/dg4/cultureheritage/cooperation/Kosovo/default_en.asp) (vizituar më 24 tetor 2013).

149. Shih Promovimi i Menaxhimit të Trashëgimisë – West (PHM) ueb-faqja <http://www.phm-west.org/phm/index.html> (vizituar më 26 Mars 2014).

150. Intervistë me drejtorin e departamentit për trashëgimi kulturore të MKRS-së, 18 dhjetor 2013.

151. Shih ueb-faqen e komunës së Hanit të Elezit/Elez Han, "10.000 € për "Promovimin e Vlerave Kulturore dhe Identifikimin e Trashëgimisë" - 06 nëntor 2013"

<http://kk.rks-gov.net/hanielezit/News/Advertisement/10-000-%E2%82%AC-per--Promovimin-e-Vlerave-Kulturore-dhe-l.aspx> (qasur më 26 Mars 2014).

152. Fushata përfshiu, mes tjerash, reklama televizive dhe postime në ueb-faqen e komunës.

153. Katalogu u lancua më 16 dhjetor 2013.


154. Neni 10, Ligji për planifikim hapësinor, shënim 34, sipër.

155. Neni 14, Ligji për planifikim hapësinor, shënim 34, sipër, thotë që "nëse Zonat e veçanta të mbrojtura janë në kuadër të Zonave Speciale, dokumentet e planifikimit hapësinor hartohen në pajtim me dispozitat e ligjit nr. 03/L-039 për Zonat e veçanta të mbrojtura". Neni 4.1 përcakton që planifikimi hapësinor dhe rregullimi do të bëhen, mes tjerash, bazuar në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Neni 10, Ligji për zonat e veçanta të mbrojtura, shënimi 21, më sipër, shtron obligimin e MMPH-së për "të siguruar që planet hapësinore për sipërfaqet brenda zonave të veçanta të mbrojtura të jenë në pajtueshmëri me nenet 5 dhe 6 të këtij ligji dhe ligjit për Planifikimin hapësinor".

156. Neni 33, Ligji për ndërtim, shënim 35, sipër.

157. Shënim 23, sipër.





Sfidat në mbrojtjen e  
trashëgimisë kulturore  
të paluajtshme  
materiale në Kosovë

Mars, 2014